



ALUMNI JOURNAL

SUCCEED
WITH
QUALITY

NĂNTOR 2010



PËRMBAJTJA:

Universiteti lider në vend, falë suksesit tuaj	3
Përmbyllja e suksesit	4-5
Gjetja e rrugëve shtesë për stabilitetin ndërkombëtar	6-7
UBT, zgjidhja më e mire	7
Studenti i UBT, anëtar i Bordit në Raiffeisen Bank	8
Fillon bashkëpunimi me Universitetin e Rijekës	9
Zyrtare e Prokurimit në AKP edhe trajnere e Prokurimit në IKAP	9
Pas UBT-së, master në Suedi dhe Finlandë	10
UBT të krijon stabilitet në punë	11
UBT fillon bashkëpunimin me Universitete në Republikën e Turqisë	11
Me njohuritë e fituara në UBT, dua ti shërbej vendit tim	12
UBT sjellë profesorë të shquar	12
UBT fillon bashkëpunimin me Universitetin City	13
Master në Angli, doktoratë në Vjenë	14
Qytetar nderi në SHBA dhe fitues i medaljes së artë	15
Punësohet në një kompani në Itali	17
Gërxhaliu: Gjatë studimeve në UBT kemi vizituar NATO-n	17
Mekatronika ishte ëndërr e imja	18-19
UBT me ligjërime të avancuar	19
Pas UBT-së, menaxhere në KEK	20
Kthehet në UBT si ligjërues dhe koordinator	21
Këshilltare në PTK	21
UBT, ndryshe nga tjerët	22
UBT me planprograme më të mira	23
UBT ka program të kompletuar	24
UBT më bëri shembull për kolegët	25
Ligjëron në UBT	26
Një menaxhere e suksesshme	26
Me UBT, të gjitha kushtet për të arritur sukses	27
Ligjërues në UBT, kandidat për doctor	28
UBT – universiteti më cilësor në Kosovë	28
Menaxhon suksesshëm në PTK	29
Nga UBT në PTK	29
Punon për Komisionin European	30
Gashi: Punoj në EULEX	30
UBT, jeni më të mirët	31

— I M P R E S U M —

UBT Alumni Journal
 KRYEREDAKTORE: Naile Demiri
 REALIZIMI TEKNIK: Herolind Beqaj
 ADRESA: www.ubt-uni.net



**UNIVERSITY EDUCATION
 FOR BUSINESS AND TECHNOLOGY**
 AMERICAN EUROPEAN UNIVERSITY

Editorial

Universiteti lider në vend, falë suksesit tuaj



EDMOND HAJRIZI
President i UBT-së

Të nderuar anëtarë të alumnit të UBT-së.

UBT vazhdon të ruaj pozitën e një universiteti lider në vend.

Akreditimi i ri dhe programet e reja të studimeve, kampusi i ri universitar, partneriteti me shumë universitete dhe institucione universitare dhe akademike, ndërlihdja e forte me ekonominë, institutet shkencore dhe hulumtuese, qendrat e ekselencës, shkalla e larte e punësimit të absolventeve janë disa prej elementeve që e mbështesin këtë fakt.

Por, para se gjithash kjo pozitë vjen si rezultat i punës së madhe dhe të palodhshme të të gjithëve në UBT, por para së gjithash si rezultat i punës studioze dhe të palodhshme që bëtë dhe po bëni ju, të absolventë dhe alumni. Me angazhimin tuaj të madh, me argumentet e shumta të paraqitura për nivelin e zhvillimit të UBT-së, mbështetur në programet dhe rezultatet studimore, duke u anëtarësuar në shumë mekanizma ndërkombëtarë, ju dhe UBT ia keni dalë të thyeni bllokadën dhe pengesat e shumta, duke u

shndërruar në ambasadorë të vendit tonë, për prezantimin e vlerave ekzistuese dhe synimeve të vendit tonë për të përqaftuar trendet më bashkëkohore të zhvillimeve në shkencë e teknologji, duke bindur dhe gjithë të tjerët se në Kosovë ka vlera që duhen çmuar e përkrahur dhe duke dëshmuar njëkohësisht se studentët dhe ekspertët kosovarë mund të përfaqësohen denjësisht në të gjitha rrethet kulminante botërore shkencore dhe ato profesionale. Me këtë ju po ndihmoni vetveten në rend të parë, por njëkohësisht po ngrini vlerat dhe cilësinë e jetës në vendin tuaj.

Prandaj ju të gjithë meritoni një respekt të veçantë dhe një falënderim të posaçëm.

Ne besojmë se ne do të vazhdojmë të bashkëpunojmë ngushtë për të mbështetur një zhvillim dhe një rritje të qëndrueshme të vendit, duke e përkrah ekselencën dhe teknologjinë e lartë por edhe duke kultivuar ndërgjegjen dhe etikën. Shpresoj të shihemi së shpejti në një

ceremoni të ardhshme të diplomimit, në një forum apo 'event' të organizuar në UBT apo nga Ju.

Risi në UBT ...

- Akreditimi ri: si institucion për tri vjet
- Programet e reja: Information systems, Professional MBA me DUK, Professional College and LLL.
- Infrastruktura: UBT po punon kampusin e ri si dhe ka krijuar Qendrën për Transferin e Teknologjisë dhe Know How.
- Ristrukturimi i UBT-së: Vice President - Derek Shields, Peter Kopacek - Head of Academic and Research Council in UBT.
- International Cooperation: City University in London, DUK, IPMA, EOQ.
- UBT and KA-CASE organizon eventin shkencor IFAC SWIIS 2010.
- Kosova Association for Management: Quality Kosova është duke studiuar dhe krijuar një brand për produkte e Kosovës që quhen Cilësia e Kosovës.
- Numri i Studentëve në UBT është rritur në krahasim me vitin e kaluar.



PËRMBYLLJA E

Në këtë ceremoni studimet bachelor i përmbyllën 280 studentë të katër Fakulteteve: Fakulteti për Menaxhment, Biznes dhe Ekonomi, Fakulteti për Drejtësi, Shkenca Politike dhe Diplomaci, Fakulteti për Shkenca Kompjuterike dhe Inxhinieri si dhe Fakulteti për Arkitekturë dhe Planifikim Hapësinor

Prishtinë, 10 korrik 2010-

Në një ceremoni madhështore, organizuar në sallën "1 Tetori" në Prishtinë, nga Universiteti për Biznes dhe Teknologji (UBT), u zhvillua Ceremonia e Diplomimit 2010, në të cilën studimet bachelor i përmbyllën 281 studentë të katër departamenteve: Fakulteti për Menaxhment, Biznes dhe Ekonomi, Fakulteti për Drejtësi, Shkenca Politike dhe Diplomaci, Fakulteti për Shkenca Kompjuterike dhe Inxhinieri si dhe Fakulteti për Arkitekturë dhe Planifikim Hapësinor.

Ceremonia u hap me antonimin e Himnit të Kosovës dhe me parakalimin e anëtarëve të Gardës Ceremoniale të Forcës së Sigurisë të Kosovës dhe vijoi me fjalën e Presidentit të UBT-së, prof.dr.Edmond Hajrizi.

Duke folur para të pranishmëve, prindër, familjarë dhe miq, përfaqësues të institucioneve të Republikës së Kosovës dhe të atyre ndërkombëtare, përfaqësues të medieve, profesorë dhe studentë të UBT-së dhe të

ftuar të tjerë z.Hajrizi tha: "Ju dëshirojmë mirëseardhje në ceremoninë e përfundimit të studimeve dhe ceremoninë e diplomimit të studentëve të nivelit bachelor në Universitetin për Biznes dhe Teknologji dhe atë për katër fakulteteve: Fakulteti për Menaxhment, Biznes dhe Ekonomi, Fakulteti për Drejtësi, Shkenca Politike dhe Diplomaci, Fakulteti për Shkenca Kompjuterike dhe Inxhinieri si dhe Fakulteti për Arkitekturë dhe Planifikim Hapësinor.

Ne jemi shumë të nderuar që ju sot jeni pjesë e kësaj ngjarjeje shumë të rëndësishme, e cila sigurisht është një prej momenteve më të veçanta në jetën e absolventëve tanë.

Kjo ceremoni është si rezultat që del nga një përkushtim i juaj disaveçar për të studiuar dhe për të ndërtuar një dije dhe një personalitet lideri në njërin prej profesioneve të zgjedhura nga ju, me qëllim të arritjes së një cilësie më të lartë jetësore për ju dhe shoqërinë.

Nevoja për një lider profesional është kërkesë e përditshme kudo në botë, por edhe në Kosovë.

Ne po kërkojmë të zhvillojmë një personalitet, i cili është shumë i përgatitur profesionalisht, është i përkushtuar në punë, ka shkallë të lartë kreativiteti dhe inovacioni, ndërton partneritete me të tjerët, ndihmon veten dhe shoqërinë, puna e tij bazohet në fakte dhe rezultate, ka një aftësi të lartë ndërkulturore dhe interdisiplinare, por ka edhe një komunikim modern të bazuar në vlerat më të larta.

Studimet në UBT kanë pasur dhe kanë pikërisht një qëllim, që bazohet në atë që thamë: ofrimin e veglave dhe aftësive të nevojshme individit për të marrë vendime racionale dhe që i garantojnë atij suksese dhe vlera që bazohen në standardet më të larta evropiane dhe ndërkombëtare.

Detyra kryesore është që t'ia ofrojmë studentit tonë të gjitha arritjet e fundit në shkencën e menaxhimit, në ekselencën biznesore, në



teknologjinë më moderne, në robotikë, në arkitekturë, në dizajn, planifikim hapësinor, marrëdhënie ndërkombëtare, diplomaci, në integritet evropiane por edhe në kompetencën sociale.

Kjo është mundësuar falë një plan-programi modern që UBT e ka krijuar, duke u bazuar në standardet evropiane dhe amerikane të studimeve por edhe në bazë të nevojave dhe kërkesave që dalin nga tregu i punës.

Po ashtu, kjo është mundësuar edhe falë angazhimit të një stafi akademik me një eksperiencë të lartë

SUKSESIT



ndërkombëtare në shkencë por edhe në aspektin profesional.

Më shumë se 250 profesorë dhe ekspertë, nga katër kontinente, nga 20 vende dhe kultura të ndryshme, nga rreth 50 e më shumë universitete dhe institucione partnere me renome botërore, po sjellin në UBT përvojën dhe dijen e tyre në këto programe ku ju, të nderuar absolventë, keni studiuar.

Kjo ka krijuar një ambient unik ndërkombëtar, ndërkulturor dhe interdisiplinar jo vetëm në Kosovë por edhe më gjerë.

Kjo i krijon UBT-së mundësinë të

ofrojë programe dhe projekte që nuk kanë qenë më parë të pranishme në Kosovë.

Dhe natyrisht kjo ditë e sotme vjen si rezultat i punës së madhe dhe të palodhshme të të gjithëve në UBT, por para së gjithash si rezultat i punës studioze dhe të palodhshme që bëtë dhe po bëni ju, të nderuar studentë dhe absolventë.

Me angazhimin tuaj të madh, me argumentet e shumta të paraqitura për nivelin e zhvillimit të UBT-së, mbështetur në programet dhe rezultatet studimore, duke u anëtarësuar në shumë mekanizma ndërkombë-

tarë, ju dhe UBT ia keni dalë të thyeni bllokadën dhe pengesat e shumta, duke u shndërruar në ambasadorë të vendit tonë, për prezantimin e vlerave ekzistuese dhe synimeve të vendit tonë për të përqaftuar trendet më bashkëkohore të zhvillimeve në shkencë e teknologji, duke bindur dhe gjithë të tjerët se në Kosovë ka vlera që duhen çmuar e përkrahur dhe duke dëshmuar njëkohësisht se studentët dhe ekspertët kosovarë mund të përfaqësohen denjësisht në të gjitha rrethet kulminante shkencore botërore.

Me këtë ju po ndihmoni vetveten por njëkohësisht po ngrini vlerat dhe cilësinë e jetës në vend.

Dhe ju të gjithë sot meritoni një respekt të veçantë dhe një falënderim të posaçëm".

Me nga një fjalë rasti ceremoninë e kanë përshëndetur edhe Peter Kopacek, Kryetari i Këshillit Akademik dhe ligjërues në UBT, ceremoni e ka përshëndetur zëvendëspresidenti i UBT Derek Shields, ndërsa në emër të Alumnit të UBT-së, ceremoninë e ka përshëndetur Arton Celina.

Pas fjalëve përshëndetëse ka vijuar ceremonia e diplomimit, me dhënien e betimit nga të porsadiplomuarit dhe me marrjen e certifikatave.

Po kështu, gjatë kësaj ceremonie janë shpallur edhe studentët e daluar të të katër Fakulteteve e, të cilët janë nderuar me certifikata. Nga Fakulteti Arkitekturë dhe Planifikim Hapësinor u certifikuan këta studentë si Anisa Kryeziu, Adea Gashi, Njomza Havolli dhe Erden Halili, nga Fakulteti për Menaxhment, Biznes dhe Ekonomi janë Ylberina Gashi, Violeta Halili, Berat Thaqi, Kaltrina Bonjaku dhe Ajete Kosumi, nga Fakulteti Shkenca Kompjuterike dhe Inxhinieri janë Visar Nura, Vedat Shaqiri, Milot Cakaj, Arlind Nushi dhe Albana Gjinolli, Adelina Shabani, Valbona Dermaku dhe Rexhep Gashi vijën nga Fakulteti Drejtësi, Shkenca Politike dhe Diplomaci.

Manifestimi është përcjellë me pika të zgjedhura muzikore, ndërsa madhështinë atij ia kanë shtuar mysafirët e shumtë, të cilët kanë madhështuar ceremoninë e diplomimit.

UBT organizoi konferencën ndërkombëtare në nivel botëror me temën "SWIIS 2010 Workshop on Supplemental Ways for Improving International Stability,"

Gjetja e rrugëve shtesë për stabilitetin ndërkombëtar

"Në qoftë se i marrim në konsideratë zhvillimet shkencore dhe teknike, kualitete e jetës do të ishte gjithnjë më i mirë. Por, siç po shihet, është shumë vështirë të krijohet një strukturë shoqërore që do të mundësonte zhvillimin e këtyre përparësive", ka deklaruar presidenti i Universitetit për Biznes dhe Teknologji (UBT), Prof. Dr. Edmond Hajrizi, duke shtuar se në botë ka një zhvillim të madhe dhe të shpejtë të shkencës dhe teknologjisë, atë masë sa njerëzimi nuk e ka përjetuar në herët.

Prishtinë, 27 tetor 2010 –

Në vazhden e ngjarjeve dhe konferencave me karakter ndërkombëtar, të organizuara në vazhdimësi nga Universiteti për Biznes dhe Teknologji (UBT) në Prishtinë, sot në këtë universitet ka nisur konferenca treditorë ndërkombëtare me temën "SWIIS 2010 Workshop on Supplemental Ways for Improving International Stability" ose "Gjeta e rrugëve shtesë për stabilitetin ndërkombëtar".

Presidenti i UBT-së, Prof. Dr. Edmond

Hajrizi, pas hapjes solemne të punimeve të konferencës, ka thënë se njerëzimi kurrë nuk ka jetuar më mirë se sot, megjithëse në të një kurrë nuk ka pasur diferenca më të mëdha në mes të sistemeve shkencore, shoqërore dhe teknike. "Në qoftë se i marrim në konsideratë zhvillimet shkencore dhe teknike, kualiteti i jetës do të ishte gjithnjë më i mirë. Por, siç po shihet, është shumë vështirë të krijohet një strukturë shoqërore që do të mundësonte zhvillimin e këtyre përparësive", ka deklaruar z. Hajrizi, duke shtuar se në botë ka zhvillim të madhe e të shpejtë të shkencës dhe teknologjisë në atë masë sa njerëzimi nuk e ka përjetuar në herët. "Ne sot po kërkojmë një model që do të përfshinte të gjithë trendët e zhvillimit, si p.sh, jemi duke e kërkuar "të menduarit e orientuar në

sistem", për të menduar në qasje ndaj sistemit, biznes exellence, sistemin e integruar të menaxhmentit, menaxhimin riskut, inovacioni, zhvillimin e qëndrueshëm, stabilitetin e sistemeve dhe përgjegjësin shoqërore", ka deklaruar Hajrizi.

Zëvendëspresidenti i UBT-së, Derek Shields, ka folur në pika të shkurtra për rendësin e zhvillimeve teknologjike, shkencore dhe shoqërore për stabilitetin ndërkombëtar.

Konferenca që mbledhi shkencëtarë, ekspert, hulumtues dhe profesorë të kësaj fushe nga institucionet ndërkombëtare, partnere të UBT-së, si dhe ekspertë vendorë të kësaj fushe.

Peter Kopacek nga Universiteti i Vjenës e Teknologjisë, falënderoj të gjithë pjesëmarrësit e konferencës dhe tha se jam i nderuar ta hapi SWIIS



2010 Workshop on Supplemental Ways for Improving International Stability".

"Arsyeja pse e kemi organizuar këtë konferencë në Kosovë është se në vitin 1983 kemi krijuar komitetin teknik për stabilitetin ndërkombëtar dhe njëri ndër qëllimet është të organizoj konferenca në shtete e reja.

Para tri vite patëm vendosë që konferencën ta organizojmë në Kosovë, si shtete i ri dhe që atëherë kemi pas të drejtë.

Për tri ditë me radhë në konferencë do prezantohen 31 punime shkencore nga 13 shtete të ndryshme. Njëri ndër qëllimet e IFAC është tu ipet rasti hulumtuesve të rinj ti prezantojë punimet shkencore", tha z. Kpacek.

Në tre sesionin e konferencës u prezantuan një varg të arriturash nga hulumtimet shkencore të pjesëmarrësve të konferencës. Sesioni i par "Zhvillimi dhe qëndrueshmëria në mjedisit", e kryesoi Peter Kopacek nga Austria. Në këtë sesion u paraqitën tre hulumtime. Për hulumtimin "Kontributi i UBT për zhvillimin e qëndrueshëm të Kosovës" folën Presidenti i UBT, Edmond Hajrizi nga Kosova, Lery Stapleton, nga Irlanda

dhe Peter Kopacek nga Austri. F. Kaltseis nga Austri prezantoi hulumtimin "Mjete dhe metodat në zhvillimin e produktit për të redaktuar ndikimin e mjedisit". Peter Kopacek dhe Ilir Rexha prezantuan hulumtimin "Menaxhimi i mbeturinave elektronike në Kosovë".

Sesioni i dytë "Modelimi dhe stimulimi" udhëheqës i sesionit në fjalë ishte G. Feichtner nga Austria. Një hulumtim paraqiti Presidenti i UBT, Prof. Dr. Edmond Hajrizi, Fatos Bakalli dhe Dr. Bekim Gashi, dhe një hulumtim N. Chivarov, nga Bullgaria.

Sesioni i tretë "Menaxhimi në Shërbimin e Stabilitetit", ku e kryesoi M. Hersh nga Skocia. Në këtë sesion punimet i paraqitën O. Zaviani, M. Braneshi nga Shqipëri, me temën "Transferimin e teknologjisë dhe sistemet e automatizimit, ndërtimi në Shqipëri".

N. Jesse nga Gjermani, foli për hulumtimin "Teknologjia dhe qendra teknologjike në Dortmund". Arian Celina "Orkestrim në shërbimin e inxhinierisë të programuar". M. Temraz nga Egjipti "Strategjitë praktike në industrinë e telekomit në kohë të vështira".

Konferenca në fjalë është organizuar nga Universiteti për Biznes dhe Teknologji (UBT) në bashkëpunim me Universitetin e Vjenës dhe Teknologjisë, Institutin për Pajisjet dhe Trajtimin e Robotikës (IHRT). Kjo konferencë është kaptinë e konferencave të Federatës Ndërkombëtare e Kontrollit Automatik (IFAC)

IFAC është themeluar në 1956 dhe momentalisht ka 50 shtete antare, dhe antari më i ri i federatës është Kosova, që është anëtarësuar përmes Universitetit për Biznes dhe Teknologji (UBT).

Universiteti për Biznes dhe Teknologji (UBT), është e nderuar, të jetë nikoqire e konferencës në fjalë, në bashkëpunim me partneret ndërkombëtare, për të organizuar konferencë të këtij niveli më këtë rast me Institutin për Pajisjet dhe Trajtimin e Robotikës (IHRT), Universitetin e Vjenës e Teknologjisë.

Punimet e konferencës vazhduan edhe më 28 dhe 29 tetor 2010, në Universitetin për Biznes dhe Teknologji (UBT), Prishtinë.

UBT, zgjidhja më e mirë



"Në ditët e sotme kur zhvillimet e mëdha dhe të shpejta dita ditës po e kaplojnë botën, në duhet të mundohemi që vazhdimisht ti përsosim aftësitë tona që në mënyrë profesionale të vazhdojmë rrugën në tregun e mbijetesës në të sotmen dhe të ardhmen, kështu, që UBT ka qenë zgjidhja më e mirë e cila na ka ofruar mundësi që të ecim në hap me kohën", thotë Ajete Kosumi e cila studimet themelore ka përfunduar në Universitetin për Biznes dhe Teknologji (UBT), në drejtimin Menaxhment Biznes dhe Ekonomi, dhe i përfundon me sukses në vitin 2010.

"Studimet nuk kanë edhe shumë kup-tim atëherë kur vërtete nuk i përjeton ato së bashku me rrethin, me shoqërinë dhe nuk i ndan me ta. Ndihma që i kemi i ofruar njëri tjetrit ka bërë që sot secili të jemi me i suksesshëm se tjetri dhe me një gëzim të veçantë kemi pritur momentet e kurorëzimit me diploma", theksoi Kosumi. Ajo më tej shton se njohuritë e fituara në UBT, po i zbaton në tregun e punës, gjë që e shih si ndihmesë të madhe për një planifikim më të suksesshëm të karrierës së saj në vazhdim.

"Profesorët e UBT-së, kanë qenë ata që kanë dhënë një kontribut të pakursyer gjatë gjithë kohës në mënyrë që ne të absorbojmë sa më shumë njohuri dhe që ato të mund të praktikojmë sot në tregun e punës ashtu siç edhe po veprojmë". Gjate viteve të studimeve si pjesë e rëndësishme kanë qenë edhe vizitat të cilat i ka organizuar UBT nëpër institucione apo ndërmarrje të rëndësishme në vend, ku nga aty studentët e fakulteti në fjalë i kanë parë për se afërmi procesin e punës ku kanë mundur të marrin njohuri të shumta. Kosumi pas diplomimit, apo më saktësisht pas përfundimit të ligjëratave të semestrit të fundit, filloi praktikën për një periudhë tre mujore në "Raiffeisen Bank", në Prishtinë, ku tashmë edhe është e punësuar me kontratë të rregullt pikërisht sektorin në Operation Department në Head Office.



Studenti i UBT, anëtar i Bordit në Raiffeisen Bank



"UBT është i vetmi universitet që ka kuadro (profesorë) internacional dhe profesional, po ashtu në bashkëpunim me shumë universitete nga Europa dhe Bota duke u nisur nga Universitetet si WUT e deri te Universiteti Oakland University", thotë Shukri Mustafa në një interviste dhënë për revistën "UBT Alumni".

Mustafa, shkollën fillore dhe të mesme ka përfunduar në vendlindje në Prishtinë kurse shkollim e lartë në Stamboll të Turqisë, si dhe certifikimin për Auditor të brendshëm në Angli gjegjësisht në Londër. Kurse studimet posdiplomike i vazhdon dhe i përfundon me sukses në Universitetin për Biznes dhe Teknologji (UBT), në Departamentin IEME. Atij i caktohet për mentor

Prof. Dr. Edmond Hajrizi, me temën "6 Sigma helping achieve Cost Reduction and Process Improvement / Productivity in the Service Industries(Bank)".

Mustafa me përfundimin studimeve dhe përvojat e fituara në UBT, ngritet në pozitë në vendin e punës. Ai më herët ka qenë auditor i brendshëm, ndërsa tashmë është anëtar i Bordit në Raiffeisen Bank, përgjegjës për IT dhe Operacione.

"Për UBT kam kujtime të shumta por dua ti veçoj vetëm disa si, eksperiencën me profesorin Bazaz , i cili ka qenë nga Oakland University dhe njëri prej profesorëve më karizmatik, po ashtu netët pa gjumë dhe mësimet në grup vetëm e vetëm të jemi në hap me ligjëruesin të nesërmen në ligjërata dhe

lidhja direkte teori-praktikë që jo shumë universitete e ofrojnë këtë mundësi. Ishte shumë e dobishme që të kesh mundësinë të shohësh atë që e ke mësuar se si praktikohet. Për çdo menaxher apo menaxhim të suksesshëm gjatë punës lind nevoja për teknika/mjete se si të bëhet apo si të arrihet deri te caku dhe UBT ofron këto teknika. Përvoja që kam fituar me këtë universitet me të vërtet më ka ndihmuar në zhvillimin e karrierës sime. UBT është universitet që ndjekë trendet botërore dhe është gjithmonë me hapin e kohës. Kjo ndihmon studentët që të njoftohem të përcjellin trendet në botë gjatë dhe pas përfundimit të studimeve", përfundoi z. Shukri Mustafa.

Fillon bashkëpunimi me Universitetin e Rijekës

Prishtinë, 6 shtator: Në kuadër të marrëveshjeve të shumta që i ka Universiteti për Biznes dhe Teknologji (UBT), me universitetet e tjera më prestigjioze në Evropë dhe Botë, Presidenti i UBT, Prof. Dr. Edmond Hajrizi dhe dekanit të Universitetit të Rijekës, Prof. Dr. Joze Piric, nënshkruan memorandumin e mirëkuptimit ndëruniversitar për të vazhduar bashkëpunimin shkencor dhe kulturor në mes dyja Universiteteve.

"UBT ka qenë gjithherë aktive në ofrimin e mundësive dhe bartjeve të dijeve nga universitetet të njohura

botërore me anë të marrëveshjeve dhe të bashkëpunimeve. Dhe një marrëveshje të tillë e kemi filluar edhe me Universitetin e Rijekës, i cili do të na mundësojë shkëmbimin e stafit akademik dhe studentëve të organizojmë seminare dhe takime tjera akademike për çështje shkencor, zbatimin e përbashkët të programeve postdiplomike, aktivitetet lidhur me kurset verore dhe takime tjera akademike për çështje të rëndësishme për të dy institucionet dhe të dy vendet", theksoi Presidenti i UBT, Edmond Hajrizi, gjatë takimit me palët

nënshkruese.

Sipas palëve nënshkruese bashkëpunimi ndëruniversitar në mes UBT dhe Universitetit të Rijekës ka filluar edhe më herët dhe pohuan se marrëveshja është incizuar nga të dy palët.

Në bazë të bisedave që patën mes udhëheqësit e institucioneve në fjalë Presidenti i UBT-së Dr. Hajrizi, u nda i kënaqur me të arritura e Universitetin e Rijekës, sidomos me programet e studimit më teknologjinë më moderne, me stafin akademik dhe me arritjet e studenteve.

Zyrtare e Prokurimit në AKP edhe trajnere e Prokurimit në IKAP



Drita Kaçandolli-Gjonbalaj. Ajo shkolimin fillor dhe të mesëm i ka përfunduar në vendlindje në Prishtinë, studimet universitare në Fakultetin e Ekonomisë në Universitetin e Prishtinës, kurse në vitin 2009 me sukses shumë të lartë përfundon studimet Master në Universitetin për Biznes dhe Teknologji (UBT), në Departamenti Prokurim dhe Menaxhment. Mentor i saj ishte Prof. Dr. Edmond Hajrizi me temën "Analiza e Efikasitetit të procesit të Prokurimit në Kosovë".

"Arsyeja kryesore pse kam vendosur të studioj është se vetëm ky universitet ka ofruar studime të tilla për "Prokurim dhe Menaxhment", jo vetëm në Kosovë por është i vetmi edhe në regjion", thotë Drita Kaçandolli-Gjonbalaj, e cila e vlerëson lartë mënyrën e organizimit të studimeve së bashku me Institutin IEME, të Austrisë, ku u janë ofruar njohuri të reja dhe përvoja nga profesorët e universiteteve, instituteve dhe kompanive të ndryshme me renome europiane dhe ndërkombëtare.

"Falë studimeve kualitative në Universitetin për Biznes dhe Teknologji (UBT), kam arritur të përfitoj njohuri të reja dhe ti zbatoj në vendin tim të punës si zyrtare e Prokurimit në

kuadër të Agjencisë Kosovare të Privatizimit. Po ashtu kohë më parë jam zgjedhur edhe si trajnere e prokurimit brenda Institutit të Administratës Publike në Kosovë (IKAP)", thotë znj.

Pas UBT-së, master në Suedi dhe Finlandë



Besar Berisha është i lindur në Podujevë. Shkollën fillore e përfundon në vendlindje kurse të mesmen drejtimin për kompjuter në "Gjin Gazulli", në Prishtinë. Diplomën në fakultetin Management Business and Ekonomi në Universitetin për Biznes dhe Teknologji. Vazhdon studimet postdiplomike në "Universitetin e Lundit", në Suedi dhe merë titullin Master of Science in Economics and Business Administration. Më pas shkon në Finland për tu punësuar si menaxher në një biznes familjar dhe gjatë kësaj kohe i lind dëshira ende për shkollim të mëtejshëm, për master, aplikon dhe pranohet në Fakultetin "Global Innovation Management" në "Universitetin e Turku", në Finlandë, dhe i ndahet bursa nga Join EU-SEE dhe Erasmus Mundus External Cooperation Window.

UBT Alumni: Çka ka qenë shtytja juaj kryesore për të studiuar në?

B. Berisha: Pas përfundimit të shkollës së mesme kishim dy zgjedhje për vazhdimin e studimeve në universitetet private dhe atë të vetmin pub-

lik në Universitetin e Prishtinës. Unë zgjodha Universitetin privat UBT për shkak të kualitetit të studimeve, kuadri akademik ndërkombëtar si dhe ligjërimit mbahet në gjuhën angleze, infrastruktura o objektit është i ngjashëm universitet europian modern, planprogrami studimor që UBT ka zhvilluar mund të them që është ndër më të mirat në Kosovë por edhe në rajon. Kurrikulat e UBT-së më kanë ndihmuar shumë në studimet e mëtejshme jashtë vendit dhe ka qenë një kurrikulë e pranuar dhe aplikuar ndërkombëtarisht. Me fillimin e studimeve në UBT gjithmonë ka qenë ambicia e përfundimit të këtyre studimeve dhe vazhdimin e tyre jashtë vendit në nivelet tjera akademike gjë që UBT ka qenë indikator apo çelësi kryesor për këtë.

UBT Alumni: Çka ju ka lënë më së shumti përshtypje gjatë studimeve në UBT?

B. Berisha: Përshtypja, pas studimeve të mia jashtë Kosovës njërin të përfunduar siç e ceka më lartë në Suedi kurse tjetërën sa kam filluar në Finlandë, jam bindur që UBT-

në për nga ana e studimeve, korrikulave, ligjëratave, ushtrimeve, vizitave studimore jashtë vendit për qëllime shkencore dhe praktike, etj është e krahasueshme nuk e ndan më universitete në Europë dhe botë.

UBT Alumni: UBT njihet si institucion që ka sjellë dhe vazhdon të sjellë në Kosovë profesorë eminentë nga e gjithë bota. Si e keni vlerësuar këtë fakt dhe sa konkretisht ju kanë ndihmuar ata?

B. Berisha: Siç e thash edhe më lartë që një ndër shkaqet që unë kam studiuar në UBT kanë qenë profesorët eminent që UBT i ka sjellë nga institucione edukative ndërkombëtare dhe mund të them që fal tyre dhe ligjërimit në gjuhën angleze kam arritur të studioj edhe jashtë Kosovës në universitete europiane.

UBT Alumni: A mund të na thoni konkretisht ku jeni duke punuar, cili është pozicioni Juaj dhe sa në të vërtetë keni arritur në karrierë deri tash?

B. Berisha: Jam duke punuar në biznesin familjar në Finlandë por jam në ndërtim e sipër të karrierës sime edhe me studime të mëtejshme në Universitetin e Turku në Finlandë ku e kam fituar edhe bursën dy vjeçare nga JoinEU-SEE dhe Erasmus Mundus External Cooperation Window që të studioj në këtë universitet.

UBT Alumni: Sa mendoni se ju ndihmon në zgjidhjen e detyrave të punës apo çështjeve të biznesit a çështjeve të ndryshme përvoja që keni fituar gjatë studimeve në UBT?

B. Berisha: Pa studimin dhe marrjen e njohurive në UBT këto detyra që i kam para vetës do të ishin detyra të pamundshme, pas studimeve në UBT këto detyra janë probleme të zgjidhshme në mënyrën më efektive të mundur.

UBT të krijon stabilitet në punë



Ekrem Rexha, ka lindur në fshatin Bresalc të Gjilanit, ndërsa me vendbanim të përhershëm në Prishtinë. Arsimin fillor, të mesëm dhe superior i ka kryer në Prishtinë. Është ekonomist i diplomuar dhe ka përfunduar një vit të studimeve posdiplomike – drejtimi i Financave në Zagreb të cilin nuk ka mundur ta përfundojë për shkak të rrethanave të krijuara në atë kohë. Një vit shkollor ka punuar profesor i lëndëve ekonomike në shkollën të mesme dhe pastaj është punësuar në Industrinë e Bukës dhe të ëmbëlsirave “Kosovarja” në Prishtinë, Fabrikë me mbi 500 punëtorë në të cilën për kohë të shkurtër ar-

riti të avancohet, në moshën 27 vjeçare në pozitën e drejtorit komercial të kësaj industrie. Në fillim të vitit 1990 është larguar nga puna nga organet e dhunshme të Serbisë dhe në ndërkohë është marrë me biznes privat, kryesisht si punëtor dhe ekspert financiar. Në fillim të vitit 2001 është punësuar në Kuvendin Komunal të Prishtinës në vendin e punës Shef i Sektorit për Ekonomi dhe në fund të vitit ka themeluar zyrën e prokurimit në Komunën e Prishtinës dhe për dy vjet ka punuar së bashku me stafin ndërkombëtar. Pas kësaj kohe, zyrën e ka menaxhuar në mënyrë të pavarur në të cilën pozitë është edhe tash. Ndër tjera, ka kryer një specializim në Torino të Italisë për rregullat e prokurimit të Bankës botërore. Në Prishtinë, nga Organet më të larta të prokurimit të Kosovës dhe nga Instituti i Kosovës për Administratë Publike është angazhuar për mbajtjen e trajnimeve për zyrtarë të prokurimit të Kosovës, të gjitha niveleve. Ka punuar në përpilimin e dosjeve të tendereve në veçanti për punë, projekte dhe koncesione dhe ka marrë pjesë në mbi 1000 vlerësime të tendereve qoftë si anëtarë i komisionit apo si vëzhgues. Gjatë vitit 2006 ka kryer me sukses studimet dhe ka marrë titullin “Ekspert ndërkombëtar për prokurim dhe menaxhment”, i çertifikuar nga UBT në

Prishtinë dhe Universiteti Yeme i Vjenës. Me 15 prill 2008 ka mbrojtur temën e magistraturës pranë UBT-së me titull: “Koncesionet si formë e zhvillimit të Komunës së Prishtinës”. Punon në Komunën e Prishtinës dhe Udhëheq Departamentin e Prokurimit.

Shtytja e tij kryesore për të studiuar në UBT ka qenë i informuar se UBT ka potencial kadrovik, ka programe të avancuara, ka menaxhment të shkëlqyer dhe ofron kushte të mjaftueshme teknike për studim cilësor, u shpreh z. Rexha, i cili

thotë se për studimet të përfunduar në UBT ka përshtypje të shkëlqyera si sistemi i mbajtjes së ligjëratave, komunikimet me mësimdhënës dhe afërsia me ta, puna në grupe e studentëve, më kanë lënë mbresa të mira. Më shumë përshtypje më ka lënë konkretizimi i mësimëve me rastet praktike. Po ashtu një përshtypje të mirë e ka edhe për mësimdhënësit i cili thotë se profesorët e jashtëm kanë sjellë padyshim cilësi të lartë. Sjellja e tyre e ka bërë UBT edhe më të respektueshëm. Shqyrtimi i disa rasteve nga praktika ime e punës me profesorët e jashtëm më ka shtuar sigurinë në vlerësimet e mija. Është i punësuar në Komunën e Prishtinës në cilësinë e Kryesuesit të Departamentit të Prokurimit. Shkollimi i kryer në UBT i ka krijuar më tepër stabilitet në punë.

UBT fillon bashkëpunimin me Universitete në Republikën e Turqisë

Universiteti për Biznes dhe Teknologji (UBT), në vazhdimësi po bashkëpunon me universitetet të njohura botërore, për bartjen dhe shkëmbin e përvojave në fushën universitare.

Një bashkëpunim të tillë e ka filluar edhe me Universitete nga Republika e Turqisë.

Një delegacion nga Universiteti UBT nga (Kosova), i prirë nga Presidenti i Universiteti UBT, Prof. Dr. Edmond Hajrizi, ka qëndruar për vizitë disa ditore në Turqi, gjegjësisht kanë vizituar Universitetin Kadir Has dhe Universitetin Amir Sinan, dhe kanë takuar menaxh-

mentin e lartë të universiteteve të cekura më lartë si Rektorët, Dekanët dhe Profesorët, me të cilët është diskutuar fillimi i bashkëpunimit në fushën akademike, shkencore dhe atë kulturore në mes e këtyre Universiteteve.

Është diskutuar mjaftë shumë edhe për zhvillimin e korrikulave, mobilitetin e stafit akademik dhe të studenteve, organizimin e eventeve shkencore në nivel regjional dhe ndërkombëtar, si dhe pjesëmarrje të

përbashkëta në projekte evropiane.

“Natyrshisht ishte një shkëmbim shumë i mirë përvojash për ne, sepse këto Universitet vërtetë kanë bërë një zhvillim të madhe dhe kanë krijuar emër në fushat e studimeve të cilat ato i ofrojnë. Prandaj, është interes i ynë që praktikatat e mira turke të bartën edhe në Kosovë”, tha Presidenti i UBT-së, Prof. Dr. Edmond Hajrizi.

Pritet që në ditët në vijim një delegacion nga këto universitete të vizitojnë edhe Kosovën gjegjësisht UBT - në.



Me njohuritë e fituara në UBT, dua ti shërbej vendit tim

“Pasi që Universiteti për Biznes dhe Teknologji (UBT), ka një përgatitje profesionale në drejtime të caktuara edhe unë vendosa që të jem pjesë e këtij universiteti në mënyrë që në të ardhmen të jem sa më e përgatitur në profesionin tim”, thotë Fatbardha Osaj, ku studimet themelore ka përfunduar në Universitetin për Biznes dhe Teknologji (UBT), në Fakultetin Shkenca Politike dhe Diplomaci, në gjuhën angleze, dhe paralelisht ka përfunduar edhe studimet në Qendrën për Studime Universitare (QSU). Fatbardha më tej shton për UBT-në, se profesorët ndërkombëtar nga vendet e ndryshme kanë sjellë përvoja të reja dhe shumë të mira tek ne, gjë që e veçon shumë universitetin dhe efikasitetin e tij.

Momentalisht jam nëntogere në FSK pasi që kam përfunduar studimet në Qendrën për Studime Universitare UBT me kë ndihmuar shumë në profesionin tim pasi që ka qenë një kombinim i njohurive nga UBT dhe QSU. Shpresoj që edhe në



të ardhmen do të më ndihmojnë njohuritë e fituara në UBT që të jem një

oficere e mirë dhe ti shërbej vendit tim, përfundoi F. Osaj.

UBT sjellë profesorë të shquar

“Vendimin për t’i vijuar studimet master në UBT, e kam marrë duke u bazuar në planprogramin që ka ofruar UBT-ja. Pra ka qenë një planprogram i lidhur ngushtë me punën që unë kryej në institucionin ku punoj”, thotë Gani Nekaj, i cili studimet postdiplomike i ka përfunduar në UBT, programin Prokurim. Ai diplomon me temën “Managing Quality in Mining Industry”. Tashmë punon si Kryesues i Departamentit të Prokurimit në KPMM.

“Përshtypjet nga UBT-ja janë të shumta duke u nisur nga mësimi cilësor, ligjëratat, profesorët si vendor ashtu ndërkombëtarë dhe UBT njihet si institucion që ka sjellë dhe vazhdon të sjellë në Kosovë profesorë eminentë nga e gjithë bota”, thotë ai.

“Sjellja e profesorëve ndërkombëtarë në vendin tonë mendoj se duhet vlerësuar shumë sepse ata kanë sjellë me vete edhe përvojat e tyre ndërkombëtare”, përfundoi Nekaj.



UBT fillon bashkëpunimin me Universitetin City

“Bashkëpunimi do të ofrojë edhe programe të tjera te veçante si janë projektet, seminarët, transferi i teknologjisë, dhe takime tjera akademike për çështje të rëndësishme për të dy institucionet dhe të dy vendet”, theksoi Presidenti i UBT, Edmond Hajrizi, gjatë takimit me palët nënshkruese



Prishtinë, 28 korrik: Në kuadër të vazhdës së Marrëveshjeve të Bashkëpunimit, që Universiteti për Biznes dhe Teknologji (UBT) i ka me universitete më prestigjioze në botë dhe Evropë, gjatë këtyre ditëve një delegacion nga Universiteti City në Londër (Angli) i prirë nga Prof. Dr. Grattan dhe Prof. Dr. Khan, po qëndron për vizitë dy ditore në Kosovë, gjegjësisht në UBT, sot më 28 korrik 2010, në ambientet e Universitetit për Biznes dhe Teknologji (UBT), për të filluar bashkëpunimit ndëruniversitar në mes të UBT-së dhe Universitetit City në Londër, Angli.

Me këtë rast, presidenti i Universitetit për Biznes dhe Teknologji (UBT), Edmond Hjarizi, së bashku me delegacionin nga Universiteti City në Londër (Angli) i prirë nga Prof. Dr. Grattan dhe Prof. Dr. Khan, në lokalet e UBT, në Prishtinë ftuan zyrtarisht të gjithë profesorët vendore dhe ndërkombëtare si dhe studentët e dy universiteteve për të qene pjese e programeve te përbashkëta te cilët ata i prezantuan.

“UBT ka qenë gjithherë aktive në

ofrimin e mundësive dhe bartjeve te dijeve nga universitetet të njohura botërore me anë të marrëveshjeve dhe të bashkëpunimeve. Dhe një marrëveshje te tillë e kemi filluar edhe me Universitetin City, i cili do te mundësoje studenteve kosovarë që studimet universitare në nivelin bachelor, master dhe në doktoraturë ti ndjekin në UBT dhe në Universitetin City, po ashtu stafit akademik zhvillim e kompetencës në fushën hulumtuese dhe zhvillimore. Bashkëpunimi do të ofrojë edhe programe të tjera te veçante si janë projektet , seminarët, transferi i teknologjisë, dhe takime tjera akademike për çështje të rëndësishme për të dy institucionet dhe të dy vendet”, theksoi Presidenti i UBT, Edmond Hajrizi, gjatë takimit me palët nënshkruese. Sipas tij, bashkëpunimi ka filluar në shtator të vitit të kaluar mes dy universiteteve,

Nga ana tjetër Prof. Dr. Grattan nga Universitetin City, pohoi se marrëveshja është incizuar nga të dy palët.

Delegacioni qëndroi dy ditë në

Kosovë pikërisht në UBT dhe u mirëpritet nga Presidenti Edmond Hajrizi dhe zëvendës-presidenti Derek Shields dhe stafi akademik vendore dhe ndërkombëtar dhe studentët e të gjitha Fakulteteve të UBT-së.

Delegacioni u nda i kënaqur me të arritura e UBT, sidomos me programet e studimit më teknologjinë më moderne, me infrastrukturën, me stafin akademik dhe me arritjet e studenteve.

Presidenti i UBT, E. Hajrizi si shenj respekti mysafirët i nderoi me simbolin më të vjetër autokton të popullit shqiptar me Plisin e bardhë.

Universitetin City numëron një numër të konsiderueshëm të mësimeve dhe ka marrëveshje shumta bashkëpunimi me universitete ndërkombëtare, është themeluar që 100 vite e më shumë, numri i të diplomuarve është i krahasueshëm me universitete më të mëdha në botë, po ashtu të diplomuarit sot janë në vende udhëheqëse nëpër kompani dhe organizata më profitabile në Evropë dhe botë.

Master në Angli, doktoratë në Vjenë



Ilir Hajdini, shkollën fillore e ka përfunduar në Podujevë kurse të mesmen në Gjimnazin matematiko-natyror në "Sami Frashëri", në Prishtinë. Në vitin 2004, fillon studimet në Universitetin për Biznes dhe Teknologji (UBT), Fakulteti Management Business and Economy, drejtimin Administrim Biznesi dhe diplomon me temën "Marrëdhënie Ndërkombëtare Ekonomike". Në vitin 2007-2009 përfundon studimet e shkallës së tretë në Britani të Madhe, në "University of Sussex". Me fjalë tjera, ka magjistruar në fushën "International Management and Innovation Management" dhe tash është kandidat për doktoraturë në Universitet të Vjenës po në drejtimin Menaxhim dhe Ekonomi.

UBT Alumni: Si keni vendosur të studioni në UBT. Çka ka qenë shtytja juaj kryesore për të studiuar në këtë universitet?

I. Hajdini: Edhe pse isha i pranuar në disa Universitete jashtë dhe brenda vendit, vendosa të studioj në UBT, pasi që kishte lami interesante për të studiuar nën përkujdesjen e një stafi akademik ndërkombëtar. Kuptohet se gjuha angleze e studimeve ka qenë boshti për të vendosur që të bëhem pjesë e UBT-së.

UBT Alumni: A mund të na rrëfeni diçka nga studimet tuaja në UBT. Çka ju ka lënë më së shumti përshtypje?

Përshtypjet më të mëdha më kanë mbetur nga përvoja praktike dhe akademike e ligjëruesve ndërkombëtar, si dhe mundësia që të involvohem në disa aspekte të menaxhimit dhe promovimit të Universitetit.

UBT Alumni: UBT njihet si institucion që ka sjellë dhe vazhdon të sjellë në Kosovë profesorë eminentë nga e gjithë bota. Si e keni vlerësuar këtë fakt dhe sa konkretisht ju kanë ndihmuar ata?

Pajtohem që kjo ka qenë pika më e rëndësishme e emrit të UBT-së të cilin e asociojmë me përvojën dhe vlerat e Profesorëve ndërkombëtar. Kuptohet që përmbytja e lendeve, metodologjia e shpjegimit dhe gjuha e ligjërimit janë pasuri që mbetet të studenti për t'i mundësuar atij të jetë më i pavarur dhe i pranueshëm në Institucionet dhe Universitet ndërkombëtare.

UBT Alumni: Pas diplomimit, Ju tani po zhvillon karrierë të suksesshme. A mund të na thoni konkretisht ku jeni duke punuar, cili është pozicioni juaj dhe sa në të vërtetë keni arritur në karrierë deri tash?

Pas diplomimit në UBT, siç e ceka më lartë, unë kam vazhduar me studime tutje në "University of Sussex", ndërsa u ktheva në Kosovë dhe menjëherë kam filluar të asistoj në fushën Menaxhimit të Kualiteteve, në Universitetin "Iliria" vetëm me profesor ndërkombëtar dhe në gjuhë angleze. Në fillim të viti akademik 2008/2009 fillova të ligjëroj edhe lëndën e Ekonomisë dhe Marketingut në Shkollën Amerikane në Kosovë, ku edhe tani jam pjesë e stafit akademik.

Njëkohësisht kam punuar edhe në publikime të tre titujve akademik në Gjermani: "Innovation Management: The Leadership Role of the CEO",

"Managing Information Technology in Global Environment", dhe "IMF's role in general and its role in Kosovo".

Ndërsa në aspektin më praktik nëse mund ta quaj, kam punuar si mbikëqyrës i shitjes në IPKO, ku për detyrë kam pasur t'i rrisë shitjet duke menaxhuar rreth 150 persona, staf shumë kreativ që punonte në sektorin e shitjes. Ndërsa me tu pranuar në PhD në Vjenë në Austri, vendosa të largohem nga IPKO, dhe të gjej një punë më karakter konsulent dmth "part time" dhe si konsulent jam i angazhuar me disa kompani Austriake, kryesisht në lëmin e hidro-centraleve ku jam duke punuar në rolin e Menaxherit të Marketingut dhe Shitjes në "NewCo IMK pipe manufacturing company".

UBT Alumni: Në profesionin Tuaj dhe në detyrat e përditshme të punës, takoheni me probleme e situata të ndryshme. Sa mendoni se ju ndihmon në zgjidhjen e detyrave të punës apo çështjeve të biznesit a çështjeve të ndryshme përvoja që keni fituar gjatë studimeve në UBT?

Po neve duhet të jemi të vetëdijshëm për rëndësinë e përvojës që një studentë e merr në studimet themelore, e atë më tepër kur këto studime i zhvillon në një ambient me profesor eminent ndërkombëtar, në gjuhë angleze dhe në ekupe punuese ku vetëm suksesi është synimi. Këto përparësi i ka ofruar UBT dhe besoj se do ndihma e këtyre cilësive është vërejtur tek secili që kemi kaluar vitet në UBT.

Në fund, mendoj se UBT duhet të vazhdojë të organizojë takime me alumnin e UBT-së, më qëllim që bashkërisht të organizojë konferenca dhe hulumtime shkencore. Po ashtu pjesëmarrës të jenë edhe profesorët ndërkombëtar, të takohet me alumnin e UBT-së për përpilimin e strategjive të marketingut, menaxhmentit, shitjes etj., të gjitha këto për UBT-në dhe studentët e saj.

Qytetar nderi në SHBA dhe fitues i medaljes së artë



Studenti i UBT-së, Jeton Ahmeti shpallet Qytetar nderi në SHBA dhe fiton medaljen të artë nga German Proficiency Badge.

"Sipas marrëveshjes mes dy institucioneve UBT- FSK, studentët e QSU kanë mundësi të shkollohen në këtë universitet. Dhe unë personalisht vendosa të studioj në UBT, sepse profesorët të cilët ligjërojnë në universitetet më të forta në Europë dhe Amerikë ligjërojnë edhe në UBT dhe programet e studimit që ofron UBT janë unike jo vetëm në vendin tonë, por edhe në rajon", tha Jeton Ahmeti, i cili studimet themelore i ka përfunduar në Fakultetin Shkenca Kompjuterike në Universitetin për Biznes dhe Teknologji UBT, ndërsa mentor i temës së diplomës i caktohet Prof. Dr. Peter Kopacek me temën "Movement Patterns of Bioid - Humanoid".

Paralelisht ai ka ndjekur edhe studimet në Qendrën për Studime Universitare(QSU) në FSK. Ahmeti një kohë qëndroi në Shtetet e Bashkuara të

Amerikës, ku mori disa certifikata në drejtimet profesionale, disa medalje të arta dhe shpallet qytetar nderi.

Në SHBA certifikohet në fushën e Sigurisë së Dhënave (Security + Professional), në Rrjeta Kompjuterike (CCNA) dhe shpallet Qytetar nderi i qytetit Huntsville Alabama, për arsye të arritjeve akademike dhe ushtarake gjatë trajnimit. Gjithashtu fiton Medaljen e Artë në German Proficiency Patch GPB në garat të cilat organizohen nga Zyra ndërlidhëse gjermane në Fort Gordon – Georgia (Baza ushtarake të cilën ka qëndruar).

Pas trajnimit punësohet në Forcën e Sigurisë së Kosovës, në Departamentin e IT-së në Komandën e Forcave Tokësore në Prishtinë, dhe po në këtë vit akademik ka regjistruar dhe është duke i vazhduar me sukses studimet Master në UBT, në Departamentin ICT (Information and Communication Technology).

"Vendosa t'i vazhdoj edhe studimet postdiplomike në UBT, sepse studimet themelore në UBT kanë qenë ndihmesë mjaft e madhe në fushën e IT-së, profesorët kanë sjellë eksperiencën e tyre tek ne, dhe ne e kemi shfrytëzuar, gjë që me ka mundësuar të mësoj gjëra të reja



nga fusha e programimit dhe teknologjisë në përgjithësi".

"Të gjitha njohuritë e mia të cilat i kam fituar në Universitetin për Biznes dhe Teknologji UBT, në Forcën e sigurisë së Kosovës FSK dhe në Amerikë do i aplikoj në vendin tim në FSK". thotë Jetoni për revistën "UBT Alumni".

Specializimet për Teknologji Informative u janë ofruar nga FSK-ja.

"Më mungojnë shprehjet që të përshkruaj UBT-në, por të studiosh në UBT është privilegj dhe nder, nuk duhet lënë pa e shfrytëzuar", është komenti i tij për UBT-në.

Jetoni është gjithashtu pjesë e ekipit të futbollit të robotëve dhe në garat Europiane në Vjenë bashkë me kolegët e tij siguroi vendin e IV-të. Ndërsa në organizimin e kampionatit Europian në Prishtinë ekipi i tij ka fituar vendin e III-të.

Trajnime dhe certifikime profesionale



Departamenti për Trajnime dhe Certifikime në UBT është shumë i angazhuar për të kontribuar në avancimin e shoqërisë kosovare në një shoqëri konkurrense, nëpërmjet trajnimeve tona profesionale, të cekura më poshtë:

Menaxhim

- Menaxhimi i Burimeve Njerëzore
- Administrim Biznesi
- Menaxhimi i Kualitetit (ISO 9001:2000)
- Menaxhimi Strategjik
- Ngritja (Themelimi) e ndërmarrjes së re
- Menaxhimi i Produktit
- Ndërtimi i Brendit
- Inxhinieringu Industrial
- Menaxhimi i Projekteve
- Menaxhimi i Proceseve
- Menaxhimi i Zinxhirit të Furnizimit
- E-Biznes
- Transport dhe Logjistikë
- Sisteme Fleksibile të Prodhimit
- Prodhimi mbështetës
- Prodhim, Planifikim dhe Skedulim
- Menaxhimi i Ndryshimeve
- Menaxhimi i Rrezikut
- Menaxhimi i Ankesave
- Menaxhimi i Kohës
- Ndërmarrësi dhe Biznisplan
- Menaxhimi i Sistemeve Informative
- Prokurimi
- Menaxhimi i Konfliktit
- Përgjegjësi Sociale e Korporatës
- Menaxhimi i Ngjarjeve
- Sistemet HACCP
- Fuzionimi dhe Bashkimi
- Planifikimi i resurseve të manufakturës
- Planifikimi i Materialeve të Kërkueshme (MRP)
- Shkathtësi negociimi
- Menaxhmenti i Logjistikës

Financa

- Raportim Financiar i Korporatës
- Tregtia e Jashtme/Doganat
- Analiza e Kostove
- Kontabilitet dhe Menaxhim i Financave
- Vendimmarrja Financiare
- Institucionet Financiare dhe Tregjet

Marketing dhe Shitje:

- Marketing dhe Shitje
- Planifikimi i Burimeve të Shpërndarjes
- Mjetet e IT për Marketing
- Menaxhimi i Lojalitetit

- Merchandising
- Modeli i Optimizimit të çmimeve
- Zhvillimi i Produkteve dhe Brendimi
- Menaxhimi i Shitjes
- Shitja Efikase dhe Teknikat e Shitjes
- Menaxhimi i Ankesave të Konsumatorëve

Shkathtësi kryesore të këshillimit:

- Menaxhimi Personal
- Komunikimi
- Punët e suksesshme grupore
- Grupimi dhe Krijimi i Grupeve
- Periodizimi
- Kodi i Etikës së Këshilltarit
- Zgjidhja e Konfliktit
- Negocimi i Kontratës
- Menaxhimi i Marrëdhënieve me Klientë
- Shërbime Këshillimi për Marketing
- Menaxhimi i Proceseve Këshilluese

Gjuhët e huaja:

- Gjuhë angleze
- Gjuhë gjermane
- Gjuhë frënge

Vërejtje e rëndësishme: Gjuhët e huaja, varësisht prej kërkesave të grupit në fokus, mund të mbahen edhe në bazë të kërkesave specifike të grupit për mësimin e terminologjive të ndryshme profesionale për gjuhët përkatëse

Drejtimi, Shkenca Politike dhe Diplomaci:

- Teknika Negocimi
- Zgjidhja e Konfliktit
- Aquri Komunitare e Bashkimit Evropian
- Institucionet e Bashkimit Evropian
- Komunikimi Masiv
- Shkathtësi Diplomatieke
- State Protocol

Mekatronikë dhe Teknologji të tjera

- Mekatronikë (Pneumatikë, Elektro-Pneumatikë, E-Teknika / Programmable Logic Controllers (PLC), Hidraulikë, Elektro-Hidraulikë, Sistemet e Kontrollit Hidraulik, Sensorët
- Design Assembly & Mirëmbajtja e Sistemeve Mekatronike
- CAx - Teknologjitë (CAD/CAM, CAQ, CAP dhe CA të tjera)
- CNC-Teknikat
- Robotikë
- Teknika të Punës/ Organizim i Punës
- Mbrojtja e Mjedisit

- Teknika të Sigurisë për mbrojtjen së punëtorëve
- Dokumentimi Teknik
- Saldimi
- Inovimi

Teknologji Informative

- CISCO
- IT Essencial
- CCNA Discovery 1.2.3.4
- CCNA Exploration 1.2.3.4
- ECDL
- Hardware
- Inxhiniering i Software (Gjuhët programuese dhe Bazat e të Dhënave)
- Rrjetizim
- Simulim i Kompjuterit
- Disenj Kompjuterik dhe Animacion
- Sisteme Aplikative të Ndërmarrjes
- Aplikime të Internetit
- Paketat CAD/CAM
- Menaxhimi i Marrëdhënieve me Konsumatorë (CRM)
- Modelimi, Optimizimi dhe simulimi

Arkitekturë dhe Planifikim Hapësinor

- Menaxhimi i Projekteve Konstruktuese
- Projektim me AUTO CAD, ARCHI CAD
- Materiale Konstruktuese dhe Kontroll Kualiteti
- Menaxhim Urban
- Certifikim për Kualitet
- Marketing në Arkitekturë

Trajnimet profesionale në disiplinat e lartcekura ofrohen në periudha të ndryshme, në bazë të kërkesës së individëve, institucioneve, kompanive dhe korporatave të ndryshme. Një grup profesionistësh vendorë dhe ndërkombëtarë, me përgatitje akademike superiore dhe përvojë të suksesshme, janë në dispozicionin tuaj për t'ju ofruar një vistër të gjerë trajnimesh për një karrierë personale të avancuar dhe për sukses të padiskutueshëm të ndërmarrjes apo institucionit tuaj.

Vërejtje e rëndësishme: Ju lutemi, mos hezitoni të kontaktoni zyrtarin përgjegjës për Trajnime profesionale në Universitetin për Biznes dhe Teknologji, përmes numrit të telefonit 038 541 400.

Punësohet në një kompani në Itali

“Qëllimi im kryesor do të jetë, që gjithë eksperiencën e arritur ta aplikoj në Kosovë”, thotë Lena Mahmuti, e cila para dy vjetëve ka përfunduar studimet themelore në Universitetin për Biznes dhe Teknologji (UBT), Departamenti Arkitekturë, e tash në prag të përfundimit të studimeve Master në Universitetin “Politecnico Di Milano” në Itali, drejtimi Arkitekturë. Ajo është në

hulumtim e sipër nëpër universitete më prestigjioze në Europë për studime të mëtutjeshme.

“Bazuar në suksesin e arritur gjatë dhe pas përfundimit të studimeve bachelor në Universitetin për Biznes dhe Teknologji, më është ndarë bursa në Universitetin “Politecnico Di Milano”, ku jam duke përfunduar studimet për master”, thotë Lena, e cila përpos

studimeve punon në kompaninë projektuese “Piramida” në qytetin Como, (në veri të Milanos), një qytet shumë i qetë, i bukur dhe me monumente shumë të vjetra historike.

Lena kolegëve të UBT-së ju drejtohet me këtë mesazh: “Secili prej kolegëve të mi apo studentët e UBT-së, mund të arrijë sukses në profesion, me përkushtim dhe punë”.

Gërxhaliu: Gjatë studimeve në UBT kemi vizituar NATO-n



“Para se të filloja studimet Master, kam hulumtuar ofertat të shumta të programeve të universiteteve tjera brenda dhe jashtë Kosovës, dhe mund të them se programi që e

ofron UBT-ja për Integrimet Europiane dhe Marrëdhëniet Ndërkombëtare më është dukur më cilësor dhe kualiteti i studimeve. Kjo edhe më ka shtyrë që të ndjek studimet në

këtë universitet me program mjaft interesant për ne dhe për vendin tonë”, thotë Magbule Gërxhaliu, e cila studimet themelore i ka mbaruar në Universitetin e Prishtinës - Fakultetin e Filologjisë-Dega Gjuhë dhe Letërsi Frënge. Gjatë viteve 2007-2009, ajo ndjekë studimet post-diplomike në Universitetin për Biznes dhe Teknologji UBT, në fushën Integritimeve Europiane dhe Marrëdhëniet Ndërkombëtare, program që e ofron për herë të parë në Kosovë dhe më gjerë, në bashkëpunim dyvjeçar me Centre International de Formation Europeenne (CIFE), në Francë. Ajo diplomon me temën “The Relationship between the European Union and North Atlantic Treaty Organization”. Gërxhaliu punon si përkthyes në KFOR, ndërsa në një të ardhme të afërt mendon të angazhohet në fushën e Integritimeve europiane apo të Diplomacisë.

“Kontaktet me profesorë ndërkombëtar kanë qenë një përvojë e cila i ka pasuruar në përgjithësi njohuritë e mia dhe besoj se automatikisht ka ndikuar në cilësinë dhe kualitetin e punës sime. Gjatë një udhëtimi studimor kemi pasur rastin që ti vizitojmë institucionet kyçe europiane të vendimmarrjes si dhe selinë e NATO-s. Mendoj se kjo vizitë na ka ndihmuar shumë në kuptimin dhe qartësimin e funksionit këtyre institucioneve”, përfundoi z. Gërxhaliu.

Mekatronika ishte ëndërr e imja



Kushtrim Dragusha i lindur në Prishtinë, shkollën fillore e ka përfunduar në "Anton Zako Çajupi" në Bardhosh, gjimnazin ka vijuar në vendlindje në shkollën "Sami Frashëri" në Prishtinë, kurse studimet universitare bachelor i përfundon në Fakultetin Menaxhimi i Mekatronikës në Universitetin për Biznes dhe Teknologji (UBT), në vitin 2008. Ai vazhdon studimet master po në të njëjtin universitet në programin Information and Communication Technology.

UBT Alumni - Si keni vendosur të studioni në UBT. Çka ka qenë shtytja juaj kryesore për të studiuar në këtë universitet?

Ideja fillestare e studimeve të suksesshme dhe koncepti për të qenë më afër studimeve europiane më bëri që të afrohem me UBT, me gjithë atë duke parë programin e UBT-së, kjo e fundit ofronte një program që nuk ekziston në Universitet tjera në tregun e Kosovës gjë që kishte indikacione më të lehta për të vendosur edhe një hap më afër UBT-së. Gjithashtu edhe drejtimi i ri që është Menaxhment i Mekatronikës ishte në ëndrrat e mia dhe nuk e kisha besimin që një universitet në Kosovë do të ofronte këtë program studimi, duke përfshirë edhe përvojat e profesorëve ndërkombëtar që ofroheshin në këtë universitet, më bëri që të vendosi shumë lehtë për profesionin dhe karrierën time dhe pjesë e rëndësishme e

se ardhmes time do të jetë UBT.

UBT Alumni- A mund të na rrëfeni diçka nga studimet tua në UBT. Çka ju ka lënë më së shumti përshtypje?

Studimet në UBT kanë lënë shumë mbresa dhe kujtime të mira, duke filluar nga profesorët dhe kolegët e duke vazhduar edhe me administratën e universitetit. Sipas mendimit tim UBT është një dritare e re për studentë, që të mund të shohin perëndimin. Në këtë universitet pika kyçe për mendimin tim është afërsia e profesorit me studentin, liria e studentit të pyesë profesorin dhe të afrohet me të për të diskutuar qoftë edhe pikat që atij i interesojnë e që janë jashtë temës së shpjegimit në orë. Hapësirat e studentit dhe angazhimet e tij për të zhvilluar projekte dhe punime shkencore obligative dhe me vetiniciative. Fuqia dhe vëmendja që i jepet studentit. Të jesh student në UBT do të thotë të jesh pjesë e rrjedhës, lëvizjes, frymëmarrjes së një bote të fuqishme shkencore dhe akademike.

UBT Alumni - UBT njihet si institucion që ka sjellë dhe vazhdon të sjellë në Kosovë profesorë eminentë nga e gjithë bota. Si e keni vlerësuar këtë fakt dhe sa konkretisht ju kanë ndihmuar ata?

Ofrimi i përvojave të profesorëve të huaj në vendin tonë është më se kruciale, duke aluduar në faktin që ne jemi në zhvillim dhe se kemi nevojë për të

absorbuar shumë përvoja të shoqërive tjera, e nëse në këtë rast bëhet filtrimi i tyre duke sjell vetëm përvojat më të suksesshme atëherë është një ndihmë shumë e madhe. Domeni i studimeve të mia në Kosovë është relativisht domen i ri dhe nuk ka has në zhvillim të mirëfilltë, dhe këto përvoja me profesorët ndërkombëtar janë të domosdoshme për të pasur mundësi të kemi një zhvillim të qëndrueshëm dhe të realizojmë pretendimet tona për arritje të kriterëve europiane.

Po kështu, UBT ofron edhe mundësinë e udhëtimeve studimore në institucione prestigjioze ndërkombëtare me të cilat ka bashkëpunim, apo edhe vizita studimore në ndërmarrje e institucione të rëndësishme në vend. Sa ju kanë ndihmuar Juve konkretisht këto vizita?

E dimë shumë mirë që në Kosovë kemi mangësi shumë të theksuara sa i përket edhe metodologjive të punës dhe studimeve. Kuptohet që pasojat janë të mëhershme si pasojë e historisë së vendit tone, po e quaj histori ngase nuk do të përsëritet dhe është e shkuar jemi duke ecur përpara. Andaj duke parë në këtë perspektiv studentet kanë nevojë të shkëmbejnë përvojat e tyre gjatë studimeve edhe me student të universiteteve tjera qoftë edhe brenda vendit por gjithë sesi me ata jashtë vendit për të parë se si zhvil-

lohet procesi dhe si punohet në këto vende, në mënyrë që të sillet përvoja më e mirë në vendin tonë, coftë në universitet apo edhe në industrinë e vendit. Kjo personalisht na ka ndihmuar shumë mua me ekipin tim, kemi bërë disa vizita në Austri, ku kemi vizituar disa laboratorë të teknologjisë, me ç'rast kemi marrë përvoja shumë të mira në bashkëpunim me studentet austriak rreth disa projekteve të nisura.


Ne këtë pikë do të kritikojmë mënyrën e funksionimit të institucioneve të arsimit të lartë, ku do të theksojmë nevojën e bashkëpunimit të Institucioneve të arsimit të lartë dhe të mundësojnë që studentet të shkëmbejnë përvojat e tyre dhe të bashkëpunojnë në projekte të ndryshme. Kjo do të ndihmonte që i tërë sistemi i arsimit do të zhvillohej edhe me hapa më të shpejt.

Pas diplomimit, Ju tani po zhviloni karrierë të suksesshme. A mund të na thoni konkretisht ku jeni duke punuar, cili është pozicioni Juaj dhe sa në të vërtetë keni arritur në karrierë deri tash?

Pas diplomimit, kam aplikuar në një pozite në njërin nga bankat vendore, konkretisht Banka për Biznes, në pozitën menaxheri i divizionit të Teknologjisë Informative, jam pranuar në këtë pozitë dhe vazhdoj të punoj rreth dy vjet duke u avancuar edhe marrë në përgjegjësi edhe operacionet e bankës. UBT në këtë rast më ka ndihmuar me përvojën e fituar në shkollim dhe më ka mundësuar që të gjitha ndryshimet që i kam bërë të kualifikohen si shumë pozitive.

Në profesionin Tuaj dhe në detyrat e përditshme të punës, takoheni me probleme e situata të ndryshme. Sa mendoni se ju ndihmon në zgjidhjen e detyrave të punës apo çështjeve të biznesit a çështjeve të ndryshme përvoja që keni fituar gjatë studimeve në UBT? Përvojat e marra në UBT me kanë ndihmuar që në vendin e punës të sjell frymë të re të punës dhe përmirësim të sistemit. Kultura e punës në grupe ka bërë që edhe problemet e hasura janë zgjidhur më lehtë dhe në mënyrë profesionale në afate rekord. Vendim marrja ka qenë më e lehtë si pasojë e informative të shumta që i kam marrë në UBT gjatë studimeve.

UBT me ligjërime të avancuar



"Ka qenë rastësi. Kam qenë i informuar nga një koleg i imi i punës. Pse UBT? Përfitim i përvojave nga jashtë pasi që të gjithë profesorët kanë qenë nga Europa", thotë Mensur Kryeziu është lindur në Dragash. Shkollën fillore dhe të mesme i ka përfunduar në vendlindje. Ka studiuar në Fakultetin e Ndërtimtarisë dhe Arkitekturës, drejtimi i Arkitekturës në Universitetin e Prishtinës (2003-2007), për ta vazhduar masterin në UBT në Fakultetin Arkitekturë dhe Planifikim Hapësinor (2007-2009).

Mënyrat më të avancuara të

ligjërit. qasjet dhe trajtimi i problemeve, ligjërimi nga profesorë ndërkombëtar vetëm në gjuhën angleze dhe material të favorshëm për çdo lëndë të studimit ishin përshtypjet e z. Kryeziut për studimet në UBT.

Punon nga shkurti i 2007 në studion projektuese Anarch. Është pjesë e strukturave udhëheqëse të kësaj kompanie.

"UBT ka qenë pjesë e rëndësishme e ngritjes së shpejtë të karrierës sime si arkitekt dhe si person me përgjegjësi në përmbushjen e obligimeve të mia ndaj kësaj kompanie", tha M. Kryeziu.



Pas UBT-së, menaxhere në KEK

“Jam me fat që më është dhënë rasti për të dëgjuar ligjërata nga profesorë me renome botërore në vendin tim, pikërisht në UBT. Me përfundimin e studimeve postdiplomike në UBT, kam kaluar në pozitën Menaxhere e Departamentit të Përkrahjes Afariste, pra “Business Support Manager”, në Divizionin e Furnizimit në Korporatën Energjetike të Kosovës, KEK”, thotë Mimoza Dugolli, për revistën “Alumni”



“Them të drejtën, kam pasur një përvojë pune në profesion relativisht të mirë, mirëpo gjatë kësaj kohe kam pasur nevojë të kem njohuri më të gjëra nga fusha e menaxhimit. Më është nevojitur të kem njohuri të mirëfillta të menaxhimit në financa, në kontabilitet, në burime njerëzore, në marketing etj. U interesova për të gjitha programet e universiteteve në përgjithësi në Kosovë. Programi IEME në UBT mu duk atraktiv dhe në të njëjtën kohë më ofronte mundësi të vazhdojnë të punoj dhe të ndjek ligjëratat”

Mimoza Dugolli është lindur në Prishtinë. Shkollën fillore dhe të mesme i përfundon në vendlindje, pra gjimnazin matematikor në “Sami Frashëri”, ndërsa studimet themelore universitare i ka përfunduar në vitin 2002, në Universitetin e Prishtinës, Fakultetin Arkitekturë. Ka punuar shtatë vite si inxhinierë në Engineering në UNMIK, ndërsa nga viti 2006 punon në Korporatën Energjetike të Kosovës, KEK. Interesimi për njohuri më të gjëra

në fushën e menaxhimit ka bërë që ajo studimet postdiplomike t’i nis dhe t’i përfundojë në Universitetin për Biznes dhe Teknologji UBT, në programin IEME dhe diplomon me temën “Identification of Commercial losses in Electrical power system in Kosovo”, te Prof. Peter Kopacek.

UBT njihet si institucion që ka sjellë dhe vazhdon të sjellë në Kosovë profesorë eminentë nga e gjithë bota dhe në fakt Mimoza paraprakisht ishte përgatitur që këto studime të jenë diçka pak më ndryshe se ligjëratat dhe studimet të cilat i pat përfunduar në Universitetin e Prishtinës. “Nivelin e ligjëruesve të këtij Universiteti nuk kam mundur ta parashikoj. Personalisht mendoj që kam pasur fat që më është dhënë rasti për të dëgjuar ligjërata nga profesorë me renome botërore, të cilët ligjërojnë në vendin tim në UBT”, e cila shton se ligjëratat kualitative jepen vetëm nga profesorë që kanë një traditë të gjatë të punës së tyre në universitetet e njohura në botë, që mund të ofrojnë përvojat të

suksesit nga karriera e tyre e suksesshme. Dhe kjo është ajo e rëndësishmja. Te gjitha tjerat janë sekondare dhe nëpërmes eksperiencës së tyre, kam parë se si funksionojnë suksesshëm kompanitë e mëdha botërore, u shpreh znj. Dugolli.

Shumica e të diplomuarave në UBT, pas diplomimit, po zhvillojnë karrierë të suksesshme, ja ku e gjejmë me punësim znj. Dugollin. “Kur kam filluar studimet në UBT, kam qenë duke e kryer detyrën e Menaxheres së Mirëmbajtjes së Objekteve, në Korporatën Energjetike të Kosovës, respektivisht kam qenë e kufizuar me punë vetëm profesionale arkitektonike. Më përfundimin e studimeve, kam kaluar në pozitën Menaxhere e Departamentit të Përkrahjes Afariste, pra “Business Support Manager”, në Divizionin e Furnizimit, në KEK, pra kam kaluar në nivel më të lartë menaxherial, me përgjegjësi më të zgjeruara”. Po ashtu znj. Dugolli thotë se pozitën që ushtron është shumë e ndërlikuar. Pra menaxhoj me Buxhetin, Prokurimin, Burimet Njerëzore, Logjistiken, etj. për Divizionin e Furnizimit, por njohuritë e marruar gjatë studimeve në UBT më është dhënë rasti t’i implementoj dhe në çdo moment të dal e suksesshëm në kompaninë ku menaxhoj, citoi Ajo.

“Unë i inkurajoj studentet e rinj të përzgjedhin këtë Universitet për studimet e tyre dhe këshilla ime për ta është që të shfrytëzojnë maksimalisht ligjëratat dhe përvojat që merren nga ligjëruesit e këtij Universiteti sepse janë të një niveli të lartë. Tani është një shanse për ta që ju ofrohet këtu, në Kosovë, shans të cilën studentët e kohës sime nuk e kanë pasur në periudhën e studimeve universitare”, përfundoi Mimoza Dugolli.

Këshilltare në PTK

“Kombinimi i profesorëve eminent nga Europa dhe Amerika kanë qenë arsyeja kryesore që më ka shtyrë ta zgjedhi UBT-në për të studiuar”, thotë znj. Metihe Arifi- Kastrati për revistën “UBT Alumni”.

“Për të rrëfyer për përvojën gjatë studimeve universitare është shumë emocionuese por vështirë për ti veçuar ato sepse, secila në cilësinë e vet ka pas peshë të rëndësishme, por do i ceki vetëm disa që vlerësoj se do të ishte me interes për lexuesit: si ndërtimi i aftësisë për të punuar në grupe. Kjo ka qenë një nga përvojat shumë të vlerësuara nga unë personalisht dhe që ende vazhdoj ta vlerësoj dhe t’i gëzojë benefitet që rrjedhimisht vijnë nga tema Work aftësi, të cilën besoj se UBT-ja të ofron më shumë se çdo universitet tjetër në Kosovë dhe udhëtimi në Vjenë të cilin e ka organizuar UBT dhe WIFI dhe ky udhëtim ka qenë një trajnim për Train the Trainer të cilin e vlerësoj si shumë pozitiv”, thotë Metihe Arifi-Kastrati, e cila përmes revistës “UBT Alumni”, falënderon drejtuesit e UBT-së që i kanë mundësuar të mësojë nga ligjërues ndërkombëtar.

“Në aspektin e mësimi dhe raportit student-profesor dhe ambienti ku kemi studiuar e kemi ndjerë veten si me qenë studentë të universiteteve europiane. I bëj thirrje të gjithë studentëve të cilët ende nuk e dinë se ku do i vazhdojnë



studimet e tyre le të angazhohen në UBT dhe ta shfrytëzojnë maksimalisht këtë mundësi se me të vërtete ia vlen, dhe në të ardhmen do të jenë mirënjohës për veten e tyre për zgjedhjen e duhur”, theksoi ajo.

Ende papërfunduar studimet znj. Metihe Arifi- Kastrati ka punuar në kompani private “Valvolub”, dhe me përfundimin e studimeve në Universitetin për Biznes dhe Teknologji (UBT), në Departamentin Management, Business and Economics, është punësuar në kompaninë më të madhe në vend, në Post Telekomin e Kosovës (PTK). Pozita e saj është Këshilltare për Burime Njerëzore pranë Zyrës së Kryeshefit Ekzekutiv të kompanisë në fjalë.

“Mendoj se ka filluar një rrugë e mbarë në jetën time pas përfundimit të studimeve të cilën e konsideroj si rezultat i punës dhe ambicieve personale”, thotë znj. Metihe, e cila gjatë gjithë kohës e përcjell mesazhin e profesorëve të vet si: “kjo çka unë e kam ligjërues jam i/e siguri që vlen deri në këtë moment, por për të ardhmen lexoni, studioni për trendet në botën e biznesit dhe ekonomisë...”.

“Dhe ky është një mesazh që të gjithë ne praktikisht duhet ta zbatojmë në qoftë se dëshirojmë të kemi një jetë më të gjatë në botën e biznesit dhe kjo pastaj vetevetiu do na ndihmojë në ndërtimin e një karriere të suksesshme”, përfundoi znj. Metihe Arifi- Kastrati.

Kthehet në UBT si ligjërues dhe koordinator

Vigan Sadiku, studimet themelore ka përfunduar në Fakultetin Management, Business and Economics në Universitetin për Biznes dhe Teknologji (UBT). Kurse studimet posdiplomike ka përfunduar në Suedi në Lund University, në Fakultetin Lund School of Economics, më konkretisht diplomon në MSc. Business Management and Economy, me temën “Performance Measurement System in the Shipping Industry”, te Prof. Olof Arwid dhe Prof. Rolf Larsson.

Pas mbarimit të studimeve z. Sadiku



është angazhuar në UBT si Koordinator për Programe Master dhe

gjithashtu si asistent në tre lëndët mësimore si: Hyrje në Kontabilitetin Financiar, Kontabilitet Menaxherial dhe Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit. “Për regjistrimin e studimeve Master nuk e kam pas vështirë sepse gjërat më kryesore që i kërkonin i pata plotësuar si: notën mesatare të studimeve themelore, njohja e gjuhës angleze, letër motivuese si dhe referenca tjera nga profesor të shumët më bënë kandidat të kompletuar për këto studime”, tha Vigan Sadiku.

UBT, ndryshe nga tjerët



Mirushe Ejupi, e lindur në fshatin Zym, komuna e Dragashit, shkollën fillore e ka kryer në fshatin Bellobrad, ndërsa gjimnazin drejtimi "matematik natyror" në Dragash. Ka përfunduar studimet bachelor për arkitekturë në UBT, ndërsa tashmë ka për objektiv studimet master jashtë vendit.

"Pas përfundimit të gjimnazit vendosa të ndjek studimet universitare, ndërsa arsyeja kryesore që më shtyri për të studiuar në UBT, ishte ajo se UBT ishte ndryshe nga Universiteti i Prishtinës, në sensin që ofronte për-

vojë ndërkombëtare.

Në UBT ligjeronin profesorë ndërkombëtarë, dhe se po të njëjtit profesorë ishin profesorë edhe në vendin e tyre. Qëllimi im ishte që të studioja arkitekturën, dhe kjo e bënte edhe më tërheqëse UBT-në. Dëshiroja dhe kisha pikësynim që të isha në rrjedha me zhvillimet arkitektonike, dizajnit, "future design" si dhe pasi të mbaroja studimet të isha e aftë për të punuar në fushën e arkitekturës, duke qenë anëtare produktive e kësaj fushe", thotë Mirushe Ejupi, per re-

visten "Alumni".

Në UBT material adekuat për të studiuar në lëndët e caktuara

Znj. Ejupi thotë se vlen të theksohet se interesim që më zgjoi edhe fakti se në UBT i mbanim ligjëratat në gjuhën angleze, pra në këtë mënyrë nuk ishte edhe vështirë të gjindej material adekuat për të studiuar për lëndët e caktuara, dhe për vazhdim të mëturjes në lëmin e saj. Vlen të theksohet që UBT aplikon planprogramin e TU-Wien (Technische Universität

Wien) gjë që do të më ndihmoj mjaft për vazhdimin e mëturjes për studimet master në këtë universitet.

Gjëja kryesore që e ka tërhequr për të studiuar në UBT ishin profesorët më eminent nga e gjithë bota. Këta profesorë kanë qenë një ndihmesë shumë e madhe për tw, afërsia dhe përpjekja e tyre e madhe për të dhënë sa më shumë dije, njohuri shumë të rëndësishme, të cilat ne tani mund ti shfrytëzojmë në punë, në praktikë, për karrierën tonë të ardhshme.

Profesorë ndërkombëtar i kanë lënë përshtypje shumë tw mira se gjatë studimeve kanë qenë pranë tyre çdo herë kur kanë pasur nevojë për përkrahje.

UBT mundëson udhëtime studimore në institucione prestigjioze ndërkombëtare. Vizita e tilla bashkë me kolegët e grupi të studimeve ka qenë në Vjenë të Austrisë. Kanë bërë vizita të ndryshme të objekteve me vlera arkitektonike, ndërmarje dhe institucione të rëndësishme dhe kanë qenë të ftuar në Universitetin Teknik të Vjenës, pasi që UBT ka edhe marrëveshje bashkëpunimi me këtë universitet, ku disa prej profesorëve të universitetit në fjalë ligjërojnë edhe në UBT. znj. Ejupi dëshiron të vazhdoj studimet Master në Universitetin Teknik të Vjenës, TU-Wien.

"Mendoj se përvoja që kemi fituar në UBT gjatë studimeve na ndihmon shumë, këtë mund ta themi gjatë bisedave me disa kolegë të cilët janë të punësuar dhe po zhvillojnë karrierë të suksesshme, që do të thotë përvoja që kemi fituar gjatë studimeve mund të na sigurojë një karrierë të suksesshme në të ardhmen", ceki ajo.

I këshillon të gjithë ata studentë të cilët mendojnë të studiojnë në UBT, që ti qasen me seriozitetin më të madh këtij qëllimi dhe se njëherazi ta konsiderojnë studimin si një obligim ku kërkohet punë. I këshillon gjithashtu që kohën në UBT ta shfrytëzojnë në maksimum, sepse gjatë leksioneve të tyre do të kenë mundësi të takojnë profesorë nga vende të ndryshme të botës të cilët bartin njohuri shumë të rëndësishme dhe "up to date" e që do t'i u nevojitet më vonë në karrierën e tyre, përfundoi znj. M. Ejupi.

UBT me planprograme më të mira



"Më ka rekomanduar një shok i imi, që është në pozitë të lartë për edukim në Europën Juglindore. Ai më ka lavdëruar planprogramet e UBT-së dhe ishte i mendimit se janë shumë më të mira se ato të AUK-ut në kuptimin e përgatitjes pas studimeve", tha Nazmije Ibrahim. Ajo ka lindur në Kroaci, shkollën fillore e ka përfunduar në Kutjevo, kurse të mesmen, drejtimi ekonomi në Pozhega, Kroaci. Kthehet në Kosovë dhe nisë studimet universitare në Universitetin për Biznes dhe Teknologji, (UBT) në Fakultetin Management, Business and Economics.

"Ishte kënaqësi ti dëgjosh profesorë ndërkombëtar gjatë ligjëratave, të cilët janë munduar dhe kanë dhënë maksimumin e tyre. Gjithmonë kanë qenë të gatshëm me ndihmë në çdo gjë që kishte lidhje me studimet. I dëgjonin studentët

me vëmendje (çdo ankese ose lëvdatë). Profesorët ishin dhe janë vlera më e madhe e këtij universiteti, pikërisht kjo ishte një stimulim për studimet e mia në UBT. Secili profesor ka ofruar diçka të ndryshme, në mënyrë të veçantë kanë përcjellë përvojat e veta tek ne. Studentët të cilët e kanë kuptuar këtë fakt, kanë pasur mundësi të përfitojnë shumë", thotë Ibrahim, e cila kur filloi studimet kishte 12 vjet përvojë pune intensive në fushën e tregtisë.

"Ka shumë gjëra që nuk i kam praktikuar, por tash pas studimeve, mësimet që i kam përvetësuar në UBT janë pjesa e përditshme e punës time si në llogaritje, analiza dhe raporte etj. Dhe jam e lumtur që kisha mundësi ti mësoj dhe ti përdori në ndërmarrjen time, "Exin" (ndërmarrja private të cilën e menaxhon me bashkëshortin e saj", përfundoi Ibrahim.

UBT ka program të kompletuar



"Arsyeja e parë për fillimin e studimeve Master në UBT ishte se ky Universitet ishte i vetmi institucion në Kosovë që kishte një program Master në Fakultetin Arkitekturë. Si dyti ky program përfshinte jo vetëm Arkitekturën, si fushë studimi, por gjithashtu Menaxhimin e Projekteve dhe Rregullimin Hapësinor. Arsye e tretë ishte se programi Master ishte i organizuar dhe ndërtuar nga një grup i profesorëve dhe ekspertëve ndërkombëtar, që më pas më dha mundësi të shumta për marrjen të përvojave dhe informatave më aktuale që kishin të bënin me lëminë tonë", thotë Petrit Ahmeti, lindur në Prishtinë, shkollimin fillor dhe të mesëm ka përfunduar në vendlindje. Studimet e nivelit "bachelor" ka përfunduar në Fakultetin e Ndërtimtarisë dhe Arkitekture, Fakulteti Arkitekture në Universitetin e Prishtinës, kurse studimet postdiplomike në Fakultetin Arkitekturë, Planifikim Hapësinor dhe Menaxhimi i Projekteve

në Universitetin për Biznes dhe Teknologji (UBT).

UBT-ja, sjellë në Kosovë profesorë eminentë nga e gjithë bota

Mënyra e studimit ishte shumë interaktive, mënyrë e cila linte hapësirë për shprehjen e kreativitetit dhe aftësive të studentëve. Gjithashtu edhe programi i studimeve, i cili për mendimin tim ishte i kompletuar, sa i përket përgatitjeve profesionale dhe akademike, citoi z. Ahmeti për revistën "Alumni". Ai shton se UBT-ja njihet si institucion që ka sjellë dhe vazhdon të sjellë në Kosovë profesorë eminentë nga e gjithë bota, ku studentëve të fakulteti në fjalë ju kanë ndihmuar shumë, duke veçuar orientimin të cilin e kanë pasur gjatë këtyre studimeve, e që është shfrytëzimi sa më efikas i energjisë përmes ndërtimeve kualitative. Njohuri që ka fituar gjatë studimeve i kanë ndihmuar shumë, që në

bashkëpunim me profesorët të fillojmë idetë e para për fillimin e implementimit projekteve me standardet më të larta të BE-së në Kosovë, tha ai. Po ashtu cek se UBT-ja ofron edhe mundësinë e udhëtimeve studimore në institucione prestigjioze ndërkombëtare me të cilat ka bashkëpunim, apo edhe vizita studimore në ndërmarrje e institucione të rëndësishme në vend dhe mua personalisht, përveç njohurive që kam marrë gjatë kohës së studimeve në UBT, mu ka dhënë mundësia e udhëtimit në Austri, si rezultat i ftesës së një nga profesorët nga Vjena, ku kam pasur mundësinë e zgjerimit të njohurive të mia profesionale, si në aspektin teorik gjithashtu edhe në atë praktik në Carinthia University of Applied Sciences. Gjithashtu edhe ekskursionet studentore të organizuara nga vet UBT.

z. Ahmeti është ka vazhduar të punoj si bashkëpunëtor i jashtëm i një kompanie projektuese dhe ndërtimore "Enggroup". Njëkohësisht është duke punuar në fushën shkencore, e cila i përket fushës së arkitekturës dhe ndërtimit në përgjithësi. Kjo punë konkretisht ka të bëjë me përgatitjen e një softuerit në gjuhën shqipe. Këtë punë është duke bërë në bashkëpunim me "PassivHaus Institut" nga Gjermania, të cilët janë inovatorët e të ashtuquajturës Shtëpi Pasive dhe krijuesit e këtij softueri, i cili është në procesin e licensimit dhe futjen e gjuhës shqipe në listën e gjuhëve të BE-së, ku njëkohësisht, gjuha shqipe do të jetë gjuha e parë nga Ballkani e cila do të futet në këtë softuer. Njëkohësisht për këtë punë ka pasur përkrahjen edhe të profesorëve të UBT-së nga Austria.

"Njohuritë që kam marrë gjatë studimeve në UBT, kanë pasur aplikim praktik gjatë punës time të përditshme me profesion. Por, unë jam i sigurt që këto njohuri vetëm sa kanë filluar të aplikohen në Kosovë e që pritet të kenë një aplikim më të madh në fushën e arkitekturës paralelisht me zhvillimin dhe aplikimin e standardeve të BE-së në Kosovë", përfundoi Petrit Ahmeti.

UBT më bëri shembull për kolegët

"Në të njëjtën kohë u bërë motiv shumë i mirë për një pjesë të stafit që planifikojnë të bëjnë ngritje profesionale e ti bashkohen UBT-së, dhe në vitin 2009 fillova në universitete si mësimdhënës, poashtu në janar të vitit 2010 nisa punën edhe si Menaxher i Zhvillimit të Projekteve", thotë Lulzim Beqiri, për revistën "Alumni".

Lulzim Beqiri i lindur në Bujanoc. Shkollimin fillor dhe të mesëm ka përfunduar në vendlindje, ndërsa studimet themelore ka përfunduar në Fakultetin Ndërtimtar dhe Arkitekture, drejtimi Arkitekturë, në Universitetin e Prishtinës. Në vitin 2007 ka filluar studimet pasdiplomike në Universitetin për Biznes dhe Teknologji (UBT), në departamentin International Engineering Management, dhe për mentor të temës caktohet te prof. dr. Peter Kopacek, me temën "Strategic Management of SME Construction Companies in Kosovo". Kurse në vitin 2010 bëhet kandidatë për doktoratë në Universitetin Teknik të Vjenës në Austri, drejtimi Menaxhimi Strategjik i Kompanive Ndërtimore, po te njëjti mentor i studimeve master.

UBT Alumni: Në UBT keni kryer studimet dhe keni fituar gradën Master. A mund të na thoni pse jeni përcaktuar pikërisht për studime në këtë universitet? Çka ju ka shtyrë të studioni në UBT?

Beqiri: Arsyeja pse e kam zgjedhur UBT-në për të zhvilluar aftësitë e mia profesionale është se në Agjencinë ku punoja Agjencia Kosovare e Pronës (KPA), është organizuar një trajnim për menaxherët e KPA-së, dhe me thënë të drejtën njohuritë që morëm nga profesorët e UBT-së gjatë këtij trajnimi na kanë bërë të mendojmë, sillemi dhe dukemi ndryshe nga që kemi qenë, prandaj kjo më ka motivuar jashtëzakonisht shumë sepse unë u binda që UBT ofron diçka që unë nuk e kam pas rastin të gjej deri atëherë.

Madje mbas trajnimit, para se të filloj studimet në UBT, unë pata edhe



disa takime me profesorin Edmond Harizin, që mund të them që është një profesor që më bën krenar mua si student i tij, dhe besoj tërë Kosovën, me përgatitjen e tij akademike, profesionale dhe qasja e tij profesionale dhe aftësitë e tij komunikative më kanë bërë që unë të vendosi të ndjek një master në UBT. Pas përfundimit të studimeve në fjalë në UBT, mund të them që nëse nuk kisha vendos me e ndjek një master të tillë tani e di që do të kisha bërë një gabim të pafalshëm.

UBT Alumni: Cilat janë përvojat që keni fituar gjatë studimeve në UBT? Na thoni ndonjë element të veçantë?

Beqiri: Janë të shumta përvojat që unë kam fituar në UBT gjatë këtij programi, përpos që janë të shumta janë ndërkombëtar dhe nga profesorë jashtëzakonisht me eksperiencë e që këto përvoja na kanë sjellë nga eksperiencia e tyre e përditshme dhe jetësore që ata kanë momentalisht apo kanë pasur në të kaluarën me kompanitë shumë të suksesshme nëpër botë dmth kompanitë që operojnë globalisht.

E veçanta e këtij programi është vizita në Austri, në kompanitë jashtëzakonisht të suksesshme, që biznesi i tyre është global, e që neve si menaxher na ka mundësuar të krijojmë një parametër matës që do të na shërbente që kompanitë ku ne operonim ti

orientojmë drejt suksesit që në vete e përjetuam gjatë kësaj vizite. Kjo neve na ka mundësuar që të punojmë në principin "Think globally, act locally", sepse pavarësisht që një kompani në Kosovë mund të jetë lider në biznesin që ata e bëjnë mendoj që parametrat matës të tyre duhet ti tejkalojnë kufijtë e Kosovës dhe sukcesi i tyre do të ishte nëse do të jenë konkurrent me bizneset globale.

Prandaj kjo vizitë ka qenë një përvojë shumë e mirë për neve dhe të them të drejtën ende e kam të freskët një porosi të një menaxheri në A1 Telekom Austria (kompani që operon në disa shtete të Evropës) që e patëm që ishte ...be better than yourself .. prandaj definitivisht ne duhet të kalojmë përtej mundësive tona po kjo ani nuk ka mundësi të bëhet pa ndonjë përgatitje profesionale të ngjashme që mund të merret në UBT, që është në Kosovë, shumë afër çdokujt.

UBT Alumni: Tani punoni në UBT si Menaxher i Zhvillimit të Projekteve njëkohësisht edhe mësimdhënës. Sa ju kanë ndihmuar studimet që keni kryer në UBT për përparim në karrierën tuaj?

Beqiri: Studimet kanë pasur një ndikim jashtëzakonisht të mirë edhe për mua si individ dmth në personalitetin tim, por edhe në punën time të përditshme, sepse pavarësisht që unë punoja si përfaqësues i zyrës Rajonale të KPA-së në Prizren nuk isha në pozitë të bëja ndryshime në Agjenci në nivelin qendror. Megjithatë këto ndryshime – përvojat e fituara nga ky program i kam aplikuar në zyrën ku operoj dhe tek bashkëpunëtorët sepse ishin përvoja që vlerësohen edhe nga bashkëpunëtorët edhe nga mjedisi ku ne operojmë.

Më pas në të njëjtën kohë u bërë motiv shumë i mirë për një pjesë të stafit që planifikojnë të bëjnë ngritje profesionale e ti bashkohen UBT-së, dhe në vitin 2009 fillova në universitete si mësimdhënës, poashtu në fillim të vitit 2010 fillova punën edhe si Menaxher i Menaxher i Zhvillimit të Projekteve.

Ligjëron në UBT

“UBT ofronte mundësinë e marrjes së njohurive nga një personel akademik ndërkombëtar, gjë që bëri, që unë me lehtësi të adoptohem në sistemin anglo-sakson të edukimit”, thotë E. Lubishtani

“Me përfundimin e studimeve pasdiplomike jam angazhuar si staf i rregullt akademik në Universitetin për Biznes dhe Teknologji (UBT), në cilësinë e asistentit nga fushat ekonomike. Po ashtu jam i angazhuar edhe në Departamentin për Menaxhment, Biznes dhe Ekonomi, si dhe në Institutin për Studime Ekonomike”, thotë Ermal Lubishtani, i cili pas përfundimit të studimeve të nivelit Bachelor në UBT, në Fakultetin Management, Business and Economics, ka vazhduar studimet Master në Mbreterinë e Bashkuar (UK), në Staffordshire University në Business School, dhe diplomoi në programin Msc in Economics for Business Analysis, me temën “The Structure-Conduct-Performance Relationship: The effects of concentration and efficiency on industry performance: A reassessment using dynamic panel models”, te Prof. Iraj Hashi, një profesor i dëshmuar nga lëmia e shkencave ekonomike.



Fitoi bursë për studimet Master në Staffordshire University

Programi, ose më mirë të themi studimet pasdiplomike, të cilin ka për-

funduar z. Lubishtani financohet nga Open Society Foundation, the Foreign and Commonwealth Office dhe Staffordshire University, Business

School. “Ishte një gare e hapur për të gjithë të interesuarit për të fituar bursë dhe për të studiuar në universitete të ndryshme. Për të fituar një bursë të tillë duhej të kalonim teste të ndryshme si nga ana e fondacionit që ofronte përkrahjen financiare po ashtu edhe nga komisioni i pranimit nga Staffordshire University, gjithashtu edhe nga Ambasada Britaneze, dhe përgatitjet e mija profesionale arrita të pajisem me bursë për vazhdimin e studimeve jashtë vendit”, ceki ai.

Po ashtu z. Lubishtani, gjatë studimeve pasdiplomike nuk e ka pasur vështirë të adaptohet në një rreth të huaj. “Ka pasur disa ngjashmëri me UBT, sepse UBT ofronte mundësinë e marrjes së njohurive nga një personel akademik ndërkombëtar, gjë që bëri, që unë me lehtësi të adoptohem në sistemin anglo-sakson të edukimit. Një dallim që unë do të kisha përmendur është përkushtimi dhe serioziteti i studenteve dhe personelit akademik në hulumtim (research) dhe në avancimin e vazhdueshëm të njohurive të tyre. Kjo me siguri vjen si rezultat i një konsolidimi të sistemit të edukimit, meritokracisë dhe sistemit të vlerave në Mbretërinë e Bashkuar”, përfundoi E. Lubishtani.

Universiteti në fjalë numëron mbi 20'000 studentë të cilët vinin nga vende dhe kultura të ndryshme të botës,

Një menaxhere e suksesshme

“Përvoja e kolegëve, mendimin e të cilëve e vlerësoj, të cilët kanë qenë pjesë e programit IEME, në kuadër të UBT dhe përmbajtja e programit ishin arsyt kryesore që më kanë bërë të besoj në cilësinë e ofruar nga ky universitet”, thotë Rajmonda Lepaja, e lindur në Gjakovë ku ka kryer shkollën fillore dhe të mesme. Shkollimin universitar e kam mbaruar në Universitetin e Tiranës në Shqipëri, kurse studimet Master ka përfunduar në

Departamentin IEME në Universitetin për Biznes dhe Teknologji (UBT).

Ajo rrëfen nga studimet në UBT, më së shumti i kanë lënë përshtypje niveli shumë i lartë i ligjërimit nga profesorë eminent para se gjithash dhe organizimi i vet universitetit për të përmbushur kërkesat e konsumatorëve të vet (studentëve), aftësitë e mira komunikuese të stafit menaxhues të UBT-së, dhe si institucion që ka sjellë dhe vazhdon të sjellë në Kosovë

profesorë eminentë nga e gjithë bota, si një nga vlerat që ky universitet ka dhe që e bën të jetë i përzgjedhur. Pas diplomimit, Rajmonda po zhvillon karrierë të suksesshme dhe është bërë pjesë e kompanisë publike në vend, Postës dhe Telekomit të Kosovës (PTK), dhe mban pozitën e Menaxheres në Qendrën e Thirrjeve. Gjatë kohës së studimeve IEME në UBT ka qenë Koordinatorë në Qendrën e Trajnimeve dhe Zhvillimeve në PTK.

Me UBT, të gjitha kushtet për të arritur sukses



“Ishte koha kur ne mbaruam studimet e shkollës së Mesme, me pretendim që do të gjenim një universitet i cili do t’i përkiste një niveli të lartë akademik njësoj si të studionim në ndonjë universitet jashtë vendit. Andaj kisha informata se një universitet i tillë ishte Universiteti për Biznes dhe Teknologji (UBT), i cili ishte i licensuar dhe me standarde të larta, që ofronte mundësi shumë të mira studimi”, thotë Samire Pireva, e cila është e lindur në Prishtinë. Shkollën e mesme “Xhevdë Doda”, Gjimnazi i Shkencave Natyrore, i ka përfunduar në Prishtinë. Ndërsa studimet i përfundoi me sukses në Universitetin për

Biznes dhe Teknologji (UBT), në Fakultetin Menaxhment, Biznes dhe Ekonomi. Ajo më tej shtonë për universitetin UBT se ishte një vend shumë i përshtatshëm për të studiuar dhe i kishte të gjitha kushtet paraprake për të arritur sukses. Në kohën kur ajo studion, UBT ishte i certifikuar me ISO:9001 standarde që për të gjithë në përgjithësi ishte edhe një dëshmi se universiteti ku studion i plotësonte të gjitha kushtet për studime Bachelor dhe Master. Përveç kushteve tjera UBT-ja njihet edhe si universitet me profesorë të shkëlqyer, shumica prej tyre studimet i kanë mbaruar në Angli, SHBA, Gjermani, Austri dhe kjo është

një gjë e mirë pasi sjellë një frymë të re të zhvillimit të mësimi, të kuptuarit e studimit dhe bëhet një kompletim i duhur i procesit mësimor, citon znj. Pireva, e cila është duke punuar si Asistente ekzekutive në Agjencinë për mbështetjen e Ndërmarrjeve të Vogla dhe të Mesme, në kuadër të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë.

Gjatë studimeve, pothuajse për çdo kurs apo lëndë kishim raste studimore, hulumtime, detyra të ndryshme si dhe prezantime të cilat ishin pjesë motivuese për të punuar dhe arritur që t’i përmbushnim studimet në kohën e caktuar, tha Samire Pireva.

Ligjërues në UBT, kandidat për doktor

"Aktualisht jam menaxher i kreative në Raiffeissen Bank, si dhe në të njëjtën kohë jam edhe ligjërues në UBT. Nëpër të gjitha pozitat e kaluara deri më tani mendoj që një shtytje të madhe më ka dhënë edhe fakti që unë kam qenë student i UBT-së", thotë Arina Meta për revistën "Alumni"

"Programi i cili ofrohet në UBT në nivelin Master si dhe ligjëruesit amerikan dhe ata europian kanë qenë një shtytje që unë të vendos që studimet e mia të nivelit Master t'i vazhdoj në UBT, poashtu edhe serioziteti i menaxhmentit të UBT dhe qasja e tyre drejt kualitetit më kanë bindur se UBT është vërtet një institucion i cili premtan për një karrierë të suksesshme në të ardhmen, thotë Arian Meta i cili ka përfunduar Fakultetin Ekonomi në Prishtinë, drejtimi Banka, Financa dhe Kontabilitet në vitin 2005. Studimet e magjistraturës i ka mbaruar në 2007 në UBT. I takon gjeneratës së dytë të programit IEME, ndërsa momentalisht është me studimet e doktoratës, ku për fushë të studimit e ka Menaxhmentin.

Krahas ligjëratave të cilat kanë qenë shumë atraktive që i mundësonin profesorët me përvojat e tyre jo vetëm në aspektin akademik por edhe atë profesional, pasi që shumica e tyre punonin



apo kishin qenë punëtor të kompanive me repute ndërkombëtare si p.sh Deloitte & Touche, Austrian Airlines, GM etj. Pastaj edhe vizitat studimore në Austri kanë qenë një përvojë e paharuar, pasi që të bësh vizita në institucione me repute si p.sh Raiffeissen International pastaj kompaninë telekomunikuese, kanë qenë përvoja shumë të mira, të cilat i kanë ndihmuar ti shohim për së afërmi se si është një funksionim i mirëfilltë i një korporate dhe në të njëjtën kohë duke ju formuar një pamje me ndryshe të operimit të biznesit në krahasim me ato të cilat kemi hasur në përditshmërinë tonë.

Përvojat e profesorëve të cilët kanë

ligjëruar në UBT, kanë qenë nga më të ndryshmet, ata krahas përvojës akademike kanë pasur edhe bagazh të profesionistëve, ata e kanë pasur të gërshetuar aspektin akademik me atë praktik. "Rast konkret është prof. Dr. Bazaz, i cili përveç që është ligjërues i lëndëve të Kontabilitetit ai po ashtu ka qenë edhe pjesë e stafit të kompanisë me repute botërore Deloitte & Touche dhe shembujt të cilët ai i shtjellonte gjatë ligjëratës akceptoheshin shumë lehtë edhe nga ata studentë të cilët nuk kishin njohuri në lëmin e Financave dhe Kontabilitetit", tha Arian Meta. Një prejtributeve që UBT-në e bën të veçohet nga të tjerët është mundësia që ajo ia ofron studentit për të bërë vizita studimore jashtë Kosovës, ky është një element i cili i ndihmon studentit që teorinë për të cilën ka dëgjuar gjatë ligjëratës ta shoh edhe në anën praktike e kjo e përforcon këtë gërshetim teori-praktike kur praktika kryhet në një vend shumë më të avancuar se Kosova siç është rasti me vizitat studimore në Austri, SHBA etj, citoi Ai. "Aktualisht jam menaxher i kreative në Raiffeissen Bank, si dhe në të njëjtën kohë jam edhe ligjërues në UBT. Nëpër të gjitha pozitat e kaluara deri më tani mendoj që një shtytje të madhe më ka dhënë edhe fakti që unë kam qenë student i UBT-së", përfundoi Arian Meta.

UBT – universiteti më cilësor në Kosovë

"Shtytja ime kryesore për të studiuar Universitetin për Biznes dhe Teknologji UBT, ka qenë e bazuar në informatat që kisha për të. UBT konsiderohej universiteti i nivelit më të lartë dhe më cilësor nga universitetet private në Kosovë si dhe prania e profesorëve të huaj me një bagazh të madh përvojë në vendet e tyre më kanë bindur se duhet të jem pjesë e këtij universiteti", tha Teuta Hoxha, e cila studimet themelore i ka përfunduar në Fakultetin e Ndërtimtari dhe Arkitekturë, Seksioni Arkitekturë

në Universitetin e Prishtinës, kurse studimet master po në të njëjtin drejtim Arkitekturë, Planifikim Hapësinor dhe Menaxhimi i Projekteve, në Universitetin për Biznes dhe Teknologji UBT. Ajo punon në kompaninë ANARCH, ku pozita e saj është arkitekte dhe drejtuese e zyrës për Kosovë dhe Tiranë.

"Njeriu mëson gjithë jetën. Me përfundimin e studimeve pasdiplomike në UBT e kam plotësuar edhe një pjesë të asaj çka i kërkohet një arkitekti", përfundoi Teuta Hoxha.



Menaxhon suksesshëm në PTK

“Njohuritë të cilat i kam përfituar nga studimet në UBT, më kanë përgatitur edhe më shumë që të ballafaqohem me problemet dhe në situata të ndryshme, e të cilat kam arritur t’i zgjidh në mënyrën më profesional, dhe prandaj them se asnjëherë nuk është vonë të jesh pjesë UBT-së, sepse do jesh falënderues gjatë gjithë karrierës tënde”, thotë Qefeser Kupina për revistën “Alumni”.

Qefeser Kupina, ekonomiste e diplomuar në Universitetin e Prishtinës, po ashtu ka përfunduar edhe një varg trajnime profesionale, trajnim të avancuar menaxheriale “Young Egzekutiv Program”, dhe së fundi ka mbrojtur punimin e magjistraturës në Universitetin për Biznes dhe Teknologji (UBT), me temë “Analiza Krahësuese e Proceseve të Buxhetimit” me fokus të veçantë në Kompanitë Publike Qendrore të Republikës së Kosovës, te Prof. Dr. Edmond Hajrizi.

“Program studimor i ofruar nga UBT, me profesorët eminent nga Evropa dhe Amerika, ka qenë një shtytje shumë e madhe që unë të orientohej për studimet posdiplomike në UBT”, tha znj. Kupina për revistën “Alumni”. Të cilës i kanë lënë përshtypje shumë të mira si metodat e avancuar të ligjërimit, organizimi i punimeve ekipore përmes grupeve të studen-



tëve, si dhe përfitimi i aftësive për të menaxhuar në mënyra dhe metoda më efikase.

Gjatë studimeve në UBT, studentët kanë mundësinë të udhëtojnë për vizita studimore në institucione pres-

tigjioze ndërkombëtare me të cilat ka bashkëpunim universiteti në fjalë, apo edhe vizita studimore në ndërmarrje e institucione të rëndësishme në vend, dhe për fat të mirë pjesë e vizita të rëndësishme ka qenë edhe znj. Kupina e cila thotë: “Nuk kisha menduar që aq lehtë do të kisha pasur mundësi të vizitoja gjithë ato ndërmarrje dhe institucione ndërkombëtare të cilën mundësi na ka ofruar UBT-ja, kështu duke më mundësuar për të parë më për së afërmi të arriturat e mëdha që çdo kush do të kishte pas dëshirë t’i shihte edhe në vendin e vetë. E këtë mundësi e ofron UBT përmes programit të vetë studimor nga i cili kam përfituar një përvojë jashtëzakonisht të mirë”.

Ajo më tej shton se njohuritë të cilat i ka fituar gjatë studimet në UBT, më kanë përgatitur edhe më shumë që të ballafaqohem me problemet dhe situata më të ndryshme, e të cilat ka arritur t’i zgjidh në mënyrën më profesional, dhe prandaj them se asnjëherë nuk është vonë të jesh pjesë UBT, sepse do jesh falënderues gjatë gjithë karrierës tënde.

Ende pa filluar dhe pas diplomimit të studimeve në UBT, znj. Kupinën e gjejmë të punësuar në Postë dhe Telekomin e Kosovës (PTK), ku aktualisht është e angazhuar në pozitë menaxheriale në Departamenti e Marketingut.

Nga UBT në PTK

“Njëra ndër arsyt kryesore që fillova studimet në Fakultetin Business Management and Economics në Universitetin për Biznes dhe Teknologji (UBT), ishte niveli i lartë i profesorëve, ligjërimit në gjuhën angleze dhe pranimi i diplomës ndërkombëtarisht”, thotë Shpëtim Sadiku, i cili shkollën e mesme ka përfunduar në Gjiminaz “Sami Frashëri” në Prishtinë.

Me mbarimin e studimeve në UBT ai fillon të punojë në kompaninë më profitabile në Kosovë, Postë dhe Telekomin e Kosovës (PTK), në pozitën Specialist i Tarifave Postare. Shpëtimi ka përfunduar edhe

një varg trajnimesh për fushën e menaxhimit të përgjithshëm për post-telekom dhe fushave relevante me këtë drejtim.

Ai thotë që studimet i kanë ndihmuar shumë si nga ana profesionale por edhe në pjekurinë dhe veprimet në të gjitha sferat e jetës.

“Përvoja e profesorëve të shkëlqyer të cilët me të cilët kemi pasur nderin të punojmë na kanë ndihmuar shumë dhe të gjitha sfidat me të cilat neve përballemi gjatë jetës janë më të lehta për t’u menaxhuar dhe ballafaquar me to”, përfundoi Shpëtim Sadiku.



Punon për Komisionin European



Informohet nga ish-studentët e Universitetit për Biznes dhe Teknologji (UBT), që në universitetin në fjalë ligjëruesit janë ndërkombëtarë dhe vijnë nga universitetet më prestigjioze nga Europa dhe Amerika. Mëson se studentët që shkollohen në UBT marrin njohuri dhe eksperiencë ndërkombëtare mjaft të pasura dhe që angazhohen në pozita menaxhuese të larta si në vendin tonë ashtu edhe jashtë tij.

Prandaj, Agnesa Vesgishi, e cila ka përfunduar studimet në Fakultetin e

Ekonomisë në Universitetin e Prishtinës në vitin 1996, merr vendim që studimet Master t'i vazhdojë në UBT, në programin më atraktiv "International Engineering Management", IEME, që e zhvillon vetëm UBT-ja në vendin tonë, por edhe në rajon. Më pas ajo edhe diplomon me temën "Investments from foreign financial Institutions during the period 2000-2008 and their impact in the job creation by SME-s in Kosovo", te Prof. Peter Kopacek.

"Ligjëratat e profesorëve nga

eksperiencë e tyre e bujshme dhe punimet grupore ka qenë hapi i parë që i kam hyrë programit në fjalë dhe njohuritë që kam marrë më ndihmojnë në punën time menaxheriale dhe në zgjidhjen e problemeve të përditshme, duke i pasur parasysh gjithmonë shembujt dhe udhëzimet e profesorëve", thotë z. Vesgishi.

Agnesa punon në Agjencionin për Zhvillim Rajonal Jug, e financuar nga Komisioni European ku pozita e saj është Udhëheqëse në Financë dhe Administratë.



Gashi: Punoj në EULEX


"Mësimdhënësit ndërkombëtarë dhe praktikantët e tyre të llojllojshme që i mungonin nivelit të edukimit universitar në Kosovë, por jo edhe UBT-së, më kanë shtyrë të studioj në UBT", thotë Albert Gashi, i cili nis studimet më 2006/2007, Dega Management and Business Administration në Fakultetin Management Business and Economics në Universitetin për Biznes dhe Teknologji (UBT).

Gashi edhe më herët ka punuar për institucione ndërkombëtare të instaluar në Kosovë ndërsa tash e dy vjet e gjejmë

në një pozitë të lakmueshme në EULEX.

"Nga UBT përfitova shumë përvoja pozitive por po i përmendi vetëm dy nga to: mësova se si zhvillohet debati profesor - student dhe anasjelltas dhe mësova me një masë shumë të madhe se si implementohet qasja teorike në praktikë. Praktikantët pozitivë që përfitova në UBT gjatë studimeve ishin dhe janë një ndihmë që ju shtua intelektit tim profesional, kështu që praktikantët e përfituara gjatë studimeve më ndihmojnë shumë në kryerjen e detyrave të mia në punë", thotë z. Gashi.

UBT, jeni më të mirët



Arbenita Krasniqi shkollën fillore e ka përfunduar në "Faik Konica", ndërsa të mesmen, drejtimi matematiko-natyror në Gjimnazin "Sami Frashëri", në Prishtinë. Studimet themelore i përfundon në Universitetin për Biznes dhe Teknologji (UBT), Fakultetin Business Management dhe diplomon me temën "Project Management Structures", te Prof. Dr. Thomas Hrabal. Më pas shfaq interesim për studime postdiplomike, në programin IEME. Përfundon provimet me sukses dhe caktohet për temën e diplomës "Mbrotjtja e të drejtave të konsumatorëve të energjisë elektrike

në Kosovë", te Prof. Peter Kopacek. Me mbarimin e studimeve fillon punën në kompani slovene "Pristop Kosova Communications LLC", të marketingut ku menaxhon të gjitha operacionet e firmës.

UBT universitet nr. 1 në Kosovë

"Unë isha ajo që mora iniciativën të hyja në këtë universitet edhe pse bëja pjesë në gjeneratën e parë dhe nuk kisha kënd ta pyesja se çfarë universiteti ishte. Informatat te gjitha i mora nga vet Universiteti dhe pash në katalog me një numër të madh profesorësh nga të gjitha anët e botës dhe

më impresionoi fakti që në Kosovë kishte një universitet të tillë. Andaj shfaqta një interesim shumë të madh dhe tani e gëzoj faktin që kam përfunduar studimet këtu dhe jam e shumë e kënaqur pasi përfitova më shumë se që kisha menduar dhe me plot vetëbesim e them se gjëja më e çmueshme e çdo njeriu është investimi në arsimimin e tij", thotë Arbenita Krasniqi, për revistën "Alumni", e cila gjithmonë i ka veçuar profesorët me një profesionalizëm të përmbledhur nga e gjithë bota sepse UBT ishte ofruesi i një arsimit shumë të çmueshëm që sipas mendimit të saj ishte dhe vazhdon të jetë nr. 1 në Kosovë. Pra, mendon se ata që kanë ditur të përfitojnë kanë përfituar shumë dhe tani janë shumë lartë në karrierë dhe ky fakt e gëzon shumë znj. Arbenita.

Pas diplomimit në UBT, Arbenita është ka zhvillon karrierë të suksesshme, ku filloi të punoj me një kompani slovene të marketingut. Fillimisht ishte e kyçur vetëm në pjesën financiare të firmës kurse tani menaxhon të gjitha operacionet e firmës.

Më tej znj. Krasniqi thotë se njohuritë e fituara në UBT po i plason në zgjidhjen e detyrave të punës apo çështjeve të biznesit, "Tri gjëra të ndihmojnë të kesh një sukses të plotë në karrierë: pjesa teorike, pjesa praktike dhe pjesa logjike. Mendoj që njëra pa tjetrën nuk mund të funksionoj siç duhet. Pjesa teorike është e mirë mirëpo nëse nuk din të bëjë lidhjen me atë praktike atëherë nuk mund të jesh i suksesshëm në punë, ndërsa pjesa e logjikës mund të them se është paksa pjesë e zhvilluar tek secili në mënyrë të ndryshme. Mua më ka ndihmuar fakti që kanë fituar njohuri teorike gjatë studimeve dhe pasi fillova ti shoh gjërat në praktike e shihja punën shumë më të lehtësuar pasi ndërldhja shumë mirë tri gjërat bashkë", thotë ajo, dhe ndihet shumë krenare me studentët të aftë që po dalin nga ky universitet, që aftësinë e tyre më se miri po e tregojnë kur po dalin në treg. "Andaj, ju si UBT vazhdoni me këtë ritëm se jeni dhe jemi më të mirët", përfundoi Arbenita Krasniqi.



Programet

Shkenca Komputerike dhe Inxhinieri (BSc, MSc)

Sistemet e Informacionit (BSc)

Përmes UBT ju mund të studioni edhe në:

Integrim dhe të drejtën Evropiane
(Master, Cife France)
Menaxhimin e Biznesit (MBA) nga
Danube University in Krems (Austri)
Information Systems (Master, WIT Ireland)

UBT është i vetmi Institucion i arsimit të lartë
certifikuar me ISO 9001



**Na kontakti në UBT,
Lagjia Kalabria p.n., Prishtinë,
Tel: 038541400,
email: info@ubt-uni.net
www.ubt-uni.net**

Që suksesi juaj të jetë i garantuar (ashtu si gjeneratat e më parshme) UBT ju ofron:

- Para studimeve dhe në fillim të studimeve - orientim profesional për secilin student

- Kurse përgatitore falas për:

• Gjatë studimeve - të njiheni me të arriturat e fundit të dijës në botë

- Metoda bashkëkohore të mësimdhënies sipas standardeve më të larta ndërkombëtare

- Studime dhe specializime interdisiplinare shumë të kërkuara në tregun e punës

- Dituritë dhe përvojat më të mira të profesorëve dhe ekspertëve eminentë nga universitetet

prestigjioze amerikane dhe evropiane, si dhe ekspertë vendas

- Ambient modern, komod dhe të pajisur me teknologji të avancuar

- UBT është institucioni i vetëm në Kosovë, i cili ofron laboratorët më bashkëkohorë të teknologjise

dhe robotikës, të simulimit të biznesit, telekomunikacionit, etj.

- UBT është institucioni i parë dhe i vetëm i arsimit të lartë në Kosovë i certifikuar me Standardin

Ndërkombëtar për Menaxhim të Cilësisë: ISO 9001.

- UBT ju ofron po ashtu:

- + Infrastrutture che ambiente moderno per studiare

- Elektronen des organischen Elektrolyten sind inaktiviert, nicht benutzbar

* Sala letimi dhe literaturë në njësi me afë të universitetit botërore

- Internet dhe Internet. Mundet e videokonferencave me kolegë nga universitetet partnere

- Për të qitë mundësi për praktikë, vizita studimore, punësim sezonale në vend dhe jashtë vendit

• **Feminine**, debate die konferensia silkenstone me karaktier natterkom batar

• Pjesemanje ni gara prestojice na karikat niderkater (ROBOTIKÉ, BIZNES PLAN, PROJEKTE)

- Plesëmirje me pagesë në projektet profesionale dhe humanitare të UBT-se

* Aktivitäre kulturelle, spirituelle, etc.

- Publikime në gazetën e Lidhjes dhe në revistat e tjera profesionale shkencore

* Träume die Cerulokome per Microsoft, CISO, IMA, QA, EOQ, etj

• TË FUNDITË SHKËRIMET E JOVE SHKËRIMORË - SHKËRIMET DHE KARRIERË TË GARANTUAR

— **Primer LGBT Alumni Association**. *Experiencie nga homet dhe institucioneve në vend dhe jashtë*

vetur leti, ofon sëmëstërie dhe brequm e punës së shpejtë për zënësim dhe karrierë.

- Të gjithë të diplomuarit e LBY-së janë me të preferuarit në punësim.

Përpos punësimit të shpejtë të tyre, ata kanë fituar edhe pozita të larta menaxhuese

në Institucionet e Kosovës dhe jashtë vendit.

Ju nuk keni nevojë të shkoni jashtë vendit për studime cilësore.

UBT ka sjellë në Kosovë trajnim e universiteteve më të mira evropiane dhe amerikane.